

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

Integriteti  
dhe  
Korrupsioni  
Policor në Shqipëri  
2.0

Tiranë 2016



Kingdom of the Netherlands



*Shënim: Ky studim u realizua në kuadër të Projektit “Indeksi i integritetit policor” i cili u mbështet nga një grant i Ministrisë së punëve të jashtme të Holandës në kuadër të Programit Matra për shtetin ligjor. Objektivat, zbatimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë holandeze.*

## STUDIUES KRYESOR

Arjan Dyrmishi

## GRUPI I STUDIUESVE

Elona Dhëmbo

Gjergji Vurmo

Sotiraq Hroni

IDM, Tiranë 2016

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim i shpreh mirënjohjen Drejtorisë së Policisë së Shtetit për bashkëpunimin dhe komunikimin e vazhdueshëm dhe të hapur lidhur me zbatimin e këtij projekti dhe realizimin e objektivave të tij.

ISBN 978-9928-4123-9-3

# **Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri**

Tiranë 2016

Botimi II

## PËRMBAJTJA

Lista e Shkurtimeve .....	7
1. Përmbledhje e gjetjeve kryesore .....	8
2. Hyrje .....	10
3. Metodologjia .....	12
3.1 Sondazhi me publikun .....	12
3.2 Sondazhi me punonjës të policisë .....	15
3.3 Intervistat me skenarë .....	17
3.4 Analiza e të dhënave .....	19
4. Dinamikat e përhapjes së korrupsionit 2014-2016 .....	20
5. Vlerësimi i kuadrit anti-korrupsion .....	24
5.1 Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 .....	24
5.2 Strategjia e Rendit Publik 2015–2020 .....	28
5.3 Kuadri ligjor .....	30
5.3.1 Ligji për PSH .....	30
5.3.2 Ligji për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat .....	31
5.3.3 Rregullorja e PSH .....	32
5.3.4 Masat anti-korrupsion .....	34
6. Kuadri institucional .....	35
7. Rezultatet në luftën kundër korrupsionit .....	36
8. Korrupsioni policor .....	44
8.1 Dinamikat e përhapjes së korrupsionit policor .....	45

8.2	Përhapja e korrupsionit sipas niveleve të menaxhimit policor .....	46
8.3	Përvojat me korrupsionin .....	49
8.4	Përhapja e korrupsionit sipas llojeve .....	50
8.5	Shkaqet e Korrupsionit .....	54
9.	Integriteti policor dhe korrupsioni .....	59
9.1	Sondazhi me policinë .....	59
9.2	Intervistat me skenarë .....	64
9.3	Vlerësimi për shkallën e seriozitetit të sjelljes .....	65
9.4	Masat disiplinore dhe aplikimi i tyre .....	68
9.5	Raportimi i shkeljeve: perceptime mbi gatishmërinë individuale dhe atë kolektive .....	73
9.6	Njohuritë objektive mbi shkeljet dhe përputhshmërinë me politikat zyrtare .....	75
9.7	Përvoja në Policinë e Shtetit dhe qëndrimet ndaj shkeljeve.....	77
10.	Përfundime dhe rekomandime .....	78
	SHTOJCA 1 - Pyetësi dhe gjetjet e anketimit me publikun .....	81
	SHTOJCA 2 - Pyetësi dhe gjetjet e anketimit me punonjësit e PSH .....	110
	SHTOJCA 3 - Intervistat me punonjës të PSH bazuar në skenarë hipotetikë ..	141
11.	Referencat .....	144
11.1	Libra artikuj dhe raporte .....	144
11.2	Akte ligjore dhe nënligjore .....	146

*“Policia është publiku dhe publiku është policia;  
policët janë thjesht pjestarë të publikut të cilët  
paguhen për t’i kushtuar vëmendje me kohë të  
plotë detyrave të cilat janë të detyrueshme për  
çdo qytetar, në interes të jetës dhe mirëqenies së  
komunitetit.”*

**Robert Peel**

Ministri i Brendshëm i Britanisë së Madhe dhe themelues  
i Forcës së Policisë Metropolitane të Londrës në 1829

**LISTA E SHKURTIMEVE**

BE	Bashkimi Evropian
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
IDRA	Instituti për Kërkime dhe Alternative Zhvillimi
KKK	Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit
PSH	Policia e Shtetit
SHKB	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
SHÇBA	Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
NKBA	Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
PD	Partia Demokratike
PS	Partia Socialiste
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit
SPSH	Strategjisë së Policisë së Shtetit

## 1. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE

Korrupsioni vazhdon të mbetet i lartë në Shqipëri duke përbërë kështu një ndër problemet kryesore që pengojnë zhvillimin ekonomik, progresin e mëtejshëm të vendit dhe realizimin e objektivave qeverisëse në tërësi, përfshirë këtu objektivin kryesor të vendit - anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Në një mjedis me korrupsion të përhapur policia ka qenë një ndër institucionet më të ekspozuara dhe më të prekura nga korrupsioni. Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme në këtë drejtim korrupsioni policor në Shqipëri nuk ka shënuar ndonjë ulje të ndjeshme.

Qeveria aktuale ka bërë një sërë përpjekjesh për trajtimin e korrupsionit në polici. Disa nga këto përpjekje lidhen me ndryshimin e legjislacionit, shtimin e masave antikorrupsion dhe synimin për një angazhim e përfshirje më të madhe të publikut.

Masa të ngjashme dhe reforma antikorrupsion janë marrë edhe në sektorë të tjerë dhe rezultatet e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International të vitit 2015 treguan për një pozicion më të mirë të Shqipërisë në renditjen botërore. Gjithsesi, perceptimi i publikut për korrupsionin policor në Shqipëri vazhdon të mbetet i lartë dhe në krahasim me vitin 2014 ka shënuar rritje të lehtë.

Në disa segmente të policisë, si shërbimi i qarkullimit rrugor, korrupsioni rezulton të jetë ulur, apo ka qëndruar i pandryshuar si në rastin e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, por është rritur në pjesën më të madhe të shërbimeve policore.

Kuadri strategjik dhe masat antikorrupsion janë zbatuar vetëm pjesërisht dhe zbatueshmëria e tyre ka hasur në pengesa, siç janë mungesa e burimeve dhe kapaciteteve të mjaftueshme, kultura e rrënjësor e tolerancës ndaj korrupsionit, besimi i ulët i publikut dhe politizimi i luftës kundër korrupsionit.

Edhe pse numri i punonjësve të policisë të hetuar dhe dënuar për korrupsion në dy vitet e fundit është rritur, shumica dërrmuese e tyre janë të rangjeve të ulta dhe të mesme, ndërkohë që ka një rritje të perceptimit të publikut për përhapjen e korrupsionit në rangjet e larta të Policisë.

Ryshfeti është forma më përhapur e korrupsionit dhe ngelet pothuajse i pandryshuar si dy vite më parë, teksa vihet re se ka një rritje në përhapjen



e llojeve të tjera të korrupsionit.

Llojet e korrupsionit që kanë shënuar rritje më të lartë janë bashkëpunimi me krimin, përfshirja në trafiqe, manipulimi i provave dhe prokurimet korruptive.

Po ashtu, ka rritje të perceptimit të korrupsionit dhe shkeljes së rregullave të Policisë në lidhje me rekrutimet, emërimet dhe gradimet.

Lufta ndaj korrupsionit dhe përpjekjet për parandalimin e korrupsionit nuk kanë dhënë rezultate në drejtim të forcimit të kulturës së integritet si instrument për t'i rezistuar tundimit për abuzim me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni i policimit.

Kultura e heshtjes ndaj denoncimit të akteve korruptive të kolegëve vazhdon të jetë kulturë dominuese në Policinë e Shtetit (PSH) dhe gatishmëria për raportimin e shkeljeve vazhdon të mbetet e ulët.

Edhe përpjekjet e bëra në 2-3 vitet e fundit për të përfshirë forcimin e kulturës së integritetit dhe antikorrupsionit në programet e edukimit dhe trinimit policor nuk kanë dhënë ndonjë efekt të dukshëm.

Përpjekjet për të përfshirë publikun për të denoncuar korrupsionin ka dhënë rezultat dhe numri i ankesave të publikut drejtuar Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat është shtuar ndjeshëm. Megjithatë, besimi i publikut si tek institucionet politike përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit ashtu edhe tek përpjekjet antikorrupsion të vetë Policisë ka shënuar rënie.

Është rritur ndjeshëm numri i qytetarëve që mendojnë se drejtuesit politikë e përdorin Policinë për qëllime korruptive dhe i qytetarëve që mendojnë se policia e përdor pozicionin që ka për qëllime korruptive.

Po kështu, qytetarët mendojnë se drejtuesit e policisë e tolerojnë korrupsionin dhe se ka një kulturë të tolerancës dhe mosveprimit ndaj korrupsionit në PSH.

Perceptimi se Policia përdoret për qëllime korruptive nga politika dhe se ndikimi i politikës në Polici ndikojnë në rritjen e korrupsionit është i përhapur edhe tek vetë punonjësit e policisë.

Përhapja e korrupsionit në shkallë të gjerë dhe për një kohë të gjatë në PSH si dhe qasja për ta luftuar korrupsionin duke trajtuar atë si problem që lidhet me sjelljen e punonjësve të veçantë të policisë kanë bërë që korrupsioni të mos trajtohet në mënyrë sistematike duke synuar

institucionin e policisë nëpërmjet forcimit të integritetit dhe të kulturës antikorruption.

Nisja nga premiset se përgjegjëse për korrupsionin në Polici janë qeveritë paraardhëse, edhe masat antikorruption të ndërmarra nga qeveri të ndryshme gjatë më shumë se 10 viteve të fundit kanë qenë me natyrë të theksuar politike. Rezultat i kësaj qasjeje ka qenë rritja e numrit të hetimeve dhe largimeve nga puna të një numri të madh punonjësish policie në vitet e para paszgjedhore, por pa trajtuar mjaftueshëm shkaqet dhe faktorët që çojnë drejt korrupsionit, faktorë që lidhen me veçoritë e shërbimeve policore dhe me kulturën e tyre organizative.

Pasojë tjetër negative e kësaj qasjeje ka qenë se PSH është konsideruar si përgjegjëse për korrupsionin. Roli i saj si aktori kryesor në luftën kundër korrupsionit në Polici është zbehur shumë, teksa Ministria e Brendshme dhe qeveria përmbushnin funksionet kontrolluese dhe monitoronin ecurinë e procesit dhe rezultatet e tij.

Liria e veprimit e punonjësve të policisë në ushtrimin e funksionit të tyre, organizimi pothuaj ushtarak dhe sekreti si dhe kultura e heshtjes dhe e solidaritetit ndërmjet kolegëve për të mos denoncuar aktet dhe veprimet e njëri-tjetrit nuk mund të ndryshohen nëse institucionit të Policisë nuk i jepet autonomia e nevojshme për të reflektuar mbi këto tipare të kulturës organizative, nuk i jepen mjetet dhe burimet për ta ndryshuar këtë kulturë por dhe nëse nuk ushtrohet kontrolli i nevojshëm për të garantuar që këto procese po ndodhin dhe ecin në drejtimin e duhur.

## 2. HYRJJE

Ky botim trajton korrupsionin në Policinë e Shtetit në Shqipëri dhe nevojën e forcimit të integritetit të institucionit të policisë si mjet për të ulur korrupsionin.

Korrupsioni mbetet një nga sfidat kryesore në Shqipëri dhe në këtë mjedis me korrupsion të lartë policia është një ndër institucionet më të ekspozuara.

Në kuadër të përpjekjeve të shoqërisë civile për të kontribuar në uljen e korrupsionit në Policinë e Shtetit (PSH), ky studim analizon korrupsionin policor në Shqipëri për periudhën 2014-2016.

Ky është studimi i dytë që i kushtohet trajtimit të korrupsionit policor në

Shqipëri, pas studimit të parë të publikuar në nëntor të vitit 2014.

Lufta kundër korrupsionit është një proces i vazhdueshëm dhe efektiviteti i masave antikorrupsion ndikohet në mënyrë thelbësore nga shkalla e njohjes së dinamikave dhe tendencave të korrupsionit dhe hartimi i strategjive dhe instrumenteve të përshtatshme.

Nisur nga ky arsytim qëllimi i këtij studimi të dytë është të japë një pamje të dinamikave të korrupsionit policor për periudhën në fjalë, e cila përkon edhe me rotacionin e politik dhe reformat antikorrupsion të ndërmarra nga qeveria aktuale, si dhe të masë efikasitetin e masave antikorrupsion.

Ashtu si edhe studimi i mëparshëm, ky studim përqendrohet në matjen e përhapjes së korrupsionit në PSH, në vlerësimin e llojeve të korrupsionit si dhe në analizimin e shkaqeve që ndikojnë në nxitjen apo frenimin e korrupsionit policor.

Studimi synon gjithashtu të shërbejë si gur kilometrik për studime të mëvonshme krahasimore në fushën e korrupsionit policor.

Pas përshkrimit të qasjes metodologjike në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, në vijim studimi jep një vështrim të korrupsionit dhe dinamikave të tij për periudhën 2014-2016 në Shqipëri përfshirë dhe një vlerësim të kuadrit antikorrupsion po për të njëjtën periudhë.

Më tej, bazuar në të dhëna të marra nga sondazh i kryer me publikun, jepet një panoramë e dinamikave të përhapjes së korrupsionit policor, llojeve të korrupsionit dhe shkaqet që nxisin korrupsionin në PSH.

Kapitulli në vijim trajton aspekte të integritetit dhe korrupsionit policor duke analizuar të dhëna të mbledhura me anë të një sondazhi dhe intervistave të kryera me punonjës të policisë.

Në pjesën e fundit jepen disa përfundime dhe rekomandime që synojnë rritjen e efektivitetit të masave dhe përpjekjeve antikorrupsion në PSH.

Me qëllim dhënien e mundësisë për të kryer analiza të mëtejshme me të dhënat e mbledhura, në shtojcat në fund të studimit jepen rezultatet e plota të sondazheve të kryera me publikun dhe punonjës të policisë.

### 3. METODOLOGJIA

Ky studim bazohet dhe zbaton një qasje dhe model kërkimor të njëjtë me atë të hartuar dhe zbatuar nga IDM në vitin 2014. Çështja që studiohet mbetet ajo e korrupsionit dhe integritetit profesional të punonjësve të policisë, duke manifestuar të njëjtat cilësi me ato që udhëhoqën procesin e konceptimit të përjasjes metodologjike të aplikuar edhe në vitin 2014. Është argumentuar edhe më herët që për studimin e çështjeve komplekse, si çështja në fjalë, kërkohet një përjasje që kombinon mjete dhe strategji, të cilat sigurojnë një përafrim sa më të madh me popullatën e synuar. Ndërthurja e metodave dhe teknikave për mbledhjen e të dhënave dhe vjeljen e opinionëve dhe qëndrimeve mbi problematikën e studiuar mundëson një trekëndëzim të burimeve të të dhënave dhe informacionit, gjë që pasuron dhe shton vlefshmërinë dhe besueshmërinë e gjetjeve të studimit.

#### 3.1 SONDAZHI ME PUBLIKUN

Për të shqyrtuar nivelet dhe format e faktorët që nxisin korrupsionin si dhe për të matur shkallën e përhapjes së tij sipas perceptimit të opinionit publik u zhvillua një intervistë e strukturuar (pyetësor). Ajo u përdor për të mbledhur opinionet dhe qëndrimet e një kampioni prej 1100 qytetarësh nga të gjitha qarqet e vendit. Në mungesë të një kuadri të saktë kampioni, d.m.th., të popullatës së detajuar për secilën zonë, dhe duke pasur parasysh lëvizjet e mëdha migratore dhe emigratore (edhe nëse do të zotëronim një kuadër të tillë), u vendos të aplikohet kampionimi me kuota, ku secila zonë, pavarësisht madhësisë së popullatës është përfaqësuar në terma të ngjashme. Përzgjedhja e kampionit kaloi në disa faza. Së pari, u përzgjedhën zonat. Çdo qendër urbane e madhe, e secilit qark, u bë pjesë e studimit. Ndërsa për garantimin e një përfaqësimi të ngjashëm të qytetarëve nga zonat e mëdha urbane ashtu dhe nga ato më të vogla dhe zonat rurale të vendit, u përzgjedhën edhe qendra e dytë më e madhe e qarkut si dhe njësi administrative më e madhe. Ndonëse zgjedhja e zonave të mesme urbane dhe atyre rurale duket e anshme, kriteri i madhësisë së zonës u kushtëzua nga kërkesa për realizimin e kampionit të synuar brenda kufizimeve buxhetore dhe kohore. Lista e zonave të përfshira në fund të procesit paraqitet më poshtë.

	Zona urbane		Zona rurale
	Qendra e qarkut	Qendra e dytë urbane e qarkut	Njësia administrative më e madhe
1	Berat	Kuçovë	Kozarë
2	Peshkopi	Bulqizë	Maqellarë
3	Durrës	Fushë-Krujë	Maminas
4	Elbasan	Librazhd	Bradashesh
5	Fier	Lushnjë	Mbrostar
6	Gjirokastrë	Tepelenë	Lazarat
7	Korçë	Pogradec	Hudenisht
8	Kukës	Bajram Curri	Shtiçen
9	Lezhë	Rrëshen	Balldre
10	Shkodër	Koplik	Bushat
11	Tiranë	Kavajë	Yzberisht
12	Vlorë	Orikum	Qendër Vlorë

***Tabela 1. Zonat e përfshira në studim***

Për administrimin e pyetësorit të perceptimit të publikut u angazhuan 14 kërkues terreni me përvoja të mëparshme. Ata u trajnuan paraprakisht mbi instrumentin, procesin dhe strategjinë në përzgjedhjen e përgjigjedhënësve. I gjithë procesi nga trajnimi i intervistuesve në kompletimin e mbledhjes dhe hedhjes së të dhënave në një bazë të dhënash zgjati 1 muaj (qershor 2016). Një sistem monitorimi u ngrit për të garantuar cilësinë e punës në terren.

Në përfundim të procesit, kampioni final manifestoi karakteristikat e paraqitura në tabelën më poshtë (Tabela 2).

	Gjinia		Zona		Mosha		Arsimi					
	F	%	F	%	F	%	F	%				
Kampioni n=1,081	Mashkull	545	50.42	Zonë urbane	635	59.12	18 - 25 vjeç	251	23.22	Arsim 8-vjeçar	566	52.70
	Femër	536	49.58	Zonë rurale	439	40.88	26- 35 vjeç	245	22.66	Arsim i mesëm	324	30.17
							36 - 45 vjeç	218	20.17	Arsim univ- sitar	59	5.49
							46 - 55 vjeç	207	19.15	Arsim pas- universitar	125	11.64
							Mbi 55 vjeç	160	14.80			

**Tabela 2.** Karakteristikat e kampionit - Sondazhi i opinionit publik, 2016

Pyetësori që u përdor për mbledhjen e të dhënave ishte i ngjashëm me atë të aplikuar në vitin 2014 për të mundur vijueshmërinë e matjes dhe krahasimet në kohë. Megjithatë, disa ndryshime u ndërmorën për të reflektuar mësimet e fituara nga përvoja e parë. Kryesisht, pati një thjeshtim dhe shkurtim të instrumentit për ta bërë atë më të menaxhueshëm dhe pranueshëm për përgjigjedhësit. Në versionin përfundimtar të tij përfshiheshin në total 40 pyetje të organizuara në disa seksione që trajtonin çështjet me interes në studim. Lista e mëposhtme paraqet seksionet/fushat e mbuluara:

- ▷ Të dhëna demografike
- ▷ Informimi mbi korrupsionin

- ▷ Perceptimet mbi korrupsionit
- ▷ Eksperienat mbi korrupsionin
- ▷ Llojet dhe shkalla e korrupsionit
- ▷ Shkaqet e jashtme të korrupsionit
- ▷ Shkaqet e brendshme të korrupsionit
- ▷ Toleranca ndaj korrupsionit
- ▷ Besimi për të luftuar korrupsionin
- ▷ Vlerësimi i kuadrit anti-korrupsion

### 3.2 SONDAZHI ME PUNONJËS TË POLICISË

Opinionet dhe qëndrimet e vetë punonjësve të policisë u shqyrtua përmes një instrumenti të konceptuar për të mundësuar marrjen e një opinioni sa më objektiv. Meqë çështja e fuqizimit të objektivitetit ka qenë e një rëndësie të veçantë edhe në studimin e 2014, instrumentit origjinal iu bënë disa ndryshime. Varianti final i pyetësorit të aplikuar për mbledhjen e të dhënave 2016 përmbante 38 pyetje të organizuara sipas seksioneve të mëposhtme:

- ▷ Të dhëna demografike
- ▷ Informimi mbi korrupsionin
- ▷ Perceptimet mbi korrupsionit
- ▷ Eksperienat mbi korrupsionin
- ▷ Llojet dhe shkalla e korrupsionit
- ▷ Shkaqet e jashtme të korrupsionit
- ▷ Shkaqet e brendshme të korrupsionit
- ▷ Toleranca ndaj korrupsionit
- ▷ Besimi për të luftuar korrupsionin
- ▷ Vlerësimi i kuadrit anti-korrupsion

Siç vihet re, ka një përputhje të qëllimshme me instrumentin e opinionit publik, gjë që mundëson edhe krahasimet ndërmjet dy popullatave të studiuara.

Kampioni prej 370 punonjës të policisë i përzgjedhur me kuota proporcionale sipas numrit të punonjësve të çdo drejtorie, komisariati dhe gradash, në të gjitha njësitë policore, në të 12 qarqet e vendit. Në përfundim të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga ky kampion, karakteristikat e tij jepen në tabelën e mëposhtme (Tabela 3):

Variabli		F	%
Gjinia	M	276	74.59
	F	94	25.41
Grupmosha	18 – 25 vjeç	50	13.51
	26- 35 vjeç	95	25.68
	36 – 45 vjeç	85	22.97
	46 – 55 vjeç	117	31.62
	Mbi 55 vjeç	23	6.22
Niveli i shkollimit	Arsim i mesëm	166	44.86
	Arsim universitar	175	47.30
	Arsim pas-universitar	29	7.84
Grada	Inspektor	279	76.66
	Krye- Inspektor	18	4.95
	Nën-Komisar	69	18.96
	Komisar	16	4.40
	Krye-Komisar	-	-
Sektori ku shërben	Policia kriminale	53	14.32
	Policia Kufitare dhe Migracionit	53	14.32
	Rendi dhe siguria publike	245	66.22
	Shërbime mbështetëse	14	3.78
	Akademia e Policisë	5	1.35
Eksperiencia me policinë e shtetit	Më pak se 5 vjet	94	25.47
	5 – 10 vjet	52	14.09
	11 – 20 vjet	123	33.33
	21 – 30 vjet	87	23.58
	Mbi 30 vjet	13	3.52

**Tabela 3.** Karakteristikat e kampionit - Sondazhi me punonjës policie, 2016.



Për pjesën më të madhe të kampionit të punonjësve të policisë u përzgjedhën punonjës terreni. Plot 259 prej tyre ose rreth 72% e kampionit ishin punonjës terreni. Ky është një kriter i rëndësishëm në raport me çështjen e studimit. Të dhënat e përfuara nga ky pyetësor u analizuan më vete, por u krahasuan edhe me gjetjet e pyetësorit për publikun.

### 3.3 INTERVISTAT ME SKENARË

Shqyrtimi dhe matja e njohurive dhe qëndrimeve të punonjësve të policisë paraqesin sfida. Tendencat e vërejtura për të qenë shoqërisht të pranueshëm dhe për të përmbushur pritshmëritë u vunë re në studimin e vitit 2014. Për këtë arsye, ashtu si edhe për arsyet origjinale të përfshirjes së vrojtimit dhe matjes përmes skenarëve konkretë, u gjykua që këtij instrumenti t'i jepej një peshë më e madhe në studimin e vitit 2016. Kjo u reflektua edhe në një rritje të kampionit të përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme prej 150 punonjësish. Ndër ta u ruajt një shpërndarje gjinore, moshore dhe e vjetërsisë në profesion që shëmbëllen raportet në popullatën kuadër të studimit – atë të forcave të policisë së shtetit. Karakteristika kryesore të tyre përmbledhen në tabelën në vijim (Tabela 4).

Shpërndarja në % e karakteristikave të kampionit								
Numri total i të pyeturve	Gjinia		Moshë		Vjetërsia në PSH		Sektori i punësimit	
	n=150	28	72	Deri në 25 vjeç	25.00	Më pak se 5 vjet	59.00	Policia kriminale
26- 35 vjeç				50.00	5 – 10 vjet	17.00	Policia Kufitare dhe Migracionit	21.00
36 – 45 vjeç				34.00	11 – 20 vjet	35.00	Rendi dhe siguria publike	114.00
46 – 55 vjeç				31.00	21 – 30 vjet	24.00	Shërbime mbështetëse	1.00
Mbi 56 vjeç				4.00	Mbi 30 vjet	7.00	Akademia e Policisë	-

**Tabela 4.** Karakteristikat e kampionit të vrojtimit përmes skenarëve, 2016

Qasja me skenarë hipotetikë është përzgjedhur me synimin për të marrë përgjigje sa më të sigjerta dhe për të shmangur rezistencën e mundshme për t'iu përgjigjur pyetjeve mbi raste reale të përfshirjes në korrupsion të vetë punonjësve të policisë apo të kolegëve të tyre. Punonjësve të anketuar iu kërkua të japin mendimet e tyre mbi 11 skenarë hipotetikë të keqsjelljes policore ku përfshihen i konflikti interesit, marrja/pranimi ryshfetit, keqpërdorimi i kompetencave, dhe vjedhja. Në thelb 10 skenarë përshkruajnë situata në të cilat qëllimi për të përfituar ndikon mbi sjelljen e punonjësit të policisë. Ndërsa një skenar përfshin përdorimin e forcës.

Secilit nga punonjësit e anketuar iu kërkua të vlerësojnë skenarët duke iu përgjigjur shtatë pyetjeve. Gjashtë nga pyetjet e parashtruara përqendrohen në pasqyrimin e integritetit policor si prirje për t'iu rezistuar tundimeve për abuzim me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni.

Nga këto, dy pyetje lidhen me faktin se sa të rëndë e perceptojnë punonjësit e policisë secilin skenar për veten e tyre dhe për punonjësit e tjerë të policisë.

Dy pyetje lidhen me masën disiplinore që punonjësit e policisë mendojnë se do të jepet dhe masën disiplinore që ata mendojnë se duhet të jepet për secilën shkelje të parashikuar në skenarë dhe dy pyetjet e tjera lidhen me gatishmërinë për të raportuar rastet e sjelljes korruptive nga vetë punonjësi i anketuar dhe mendimin e tij për gatishmërinë për të raportuar të punonjësve të tjerë.

Pyetja e tjetër (nr. 3) synon të marrë përgjigje nëse punonjësit e policisë mendojnë se sjellja e përshkruar në skenar përbënte shkelje të politikës zyrtare të institucionit të policisë.

Anketimi u krye me mbështetjen e drejtuesve të Policisë së Shtetit gjatë muajve qershor dhe korrik 2016. Në secilën njësi policore ku u krye anketimi, punonjësit e policisë i plotësuan pyetësorët njëkohësisht në mjedise të ofruara nga njësitë policore.

Për realizimin e mbledhjes së të dhënave nga punonjësit e policisë ka qenë e domosdoshme ndihma dhe bashkëpunimi me Drejtorinë e Standardeve Profesionale pranë Policisë së Shtetit. Kjo drejtori miratoi dhe lehtësoi zhvillimin e anketimit me 370 punonjësish policie në të gjithë vendin sipas specifikimeve si dhe me 150 punonjës të tjerë policie për sondazhin me skenarët hipotetikë. Administrimi i anketimit me punonjësit e policisë dhe skenarët hipotetikë u zhvillua në fund të muajit qershorit deri në fund të korrikut 2016.

Administrimi i këtyre dy instrumenteve u zhvillua nga dy specialistë të IDM me përvojë në zhvillimin e sondazheve. Sipas shpërndarjes së

kampionit të caktuar, drejtoritë vendore të policisë u njoftuan paraprakisht për zhvillimin e anketimit në vendin e punës.

Administrimi i anketimit me skenarët hipotetikë u zhvillua në 10 njësi policore në Tiranë duke përdorur një kuotë të barabartë prej 15 pyetësorësh. Më poshtë paraqitet lista e njësisve policore të anketuara:

1. Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë
2. Komisariati Policisë Nr.1 Tiranë
3. Komisariati Policisë Nr.2 Tiranë
4. Komisariati Policisë Nr.3 Tiranë
5. Komisariati Policisë Nr.4 Tiranë
6. Komisariati Policisë Nr.5 Tiranë
7. Komisariati Policisë Nr.6 Tiranë
8. Komisariati Policisë Kavajë Tiranë
9. Komisariati Rajonal i Policisë Rrugore Tiranë
10. Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Tiranë

Qasja për ta kryer sondazhin vetëm në Tiranë lidhet me tre arsyetime të kryera nga grupi i studiuesve. Së pari, është marrë në konsideratë fakti që Policia e Shtetit është institucion i organizuar vertikalisht dhe me rregulla unike që aplikohen njëtrajtësisht në të gjithë territorin e vendit, kështu që gjetjet e pyetësorit në Tiranë mund të konsiderohen të vlefshme për Policinë e Shtetit në tërësi. Së dyti, Tirana është njësi më e madhe administrative në vend dhe ku punonjësit e policisë kanë më shumë gjasa për t'u ballafaquar me një shumëllojshmëri situatash dhe mundësish për t'u përfshirë në sjellje korruptive. Së treti, nga analiza e të dhënave të sondazheve të kryera me publikun dhe policinë ndryshimet sipas qarqeve kanë qenë të mjaft të vogla, kështu që përfundimet e nxjerra mund të jenë të aplikueshme për Policinë e Shtetit në tërësi. Megjithatë, kjo nuk përjashton rëndësinë e kryerjes së pyetësorit edhe në qytete të tjera në raste të mëvonshme për të parë ndryshime të mundshme dhe për të analizuar shkaqet e ndryshimeve eventuale.

### 3.4 ANALIZA E TË DHËNAVE

Hedhja e të dhënave në bazë të dhënash u zhvillua nga dy specialistë dhe përpunimi i të dhënave u krye nga një ekspert i statistikave. Në analizën e tyre janë përdorur statistika përshkruese. Në studim bëhen një seri krahasimesh në kohe dhe ndërmjet kategorish. Kështu, krahasohet midis dy studimeve të vitit 2014 dhe 2016. Gjithashtu, disa karakteristika janë përdorur si kategori reference për të parë prirje dhe ndryshime të

mundshme. Një shembull konkret është krahasimi i dy nënkategorive të punonjësve në rastin e skenarëve ku hipotetizojmë që përvoja me Policinë e Shtetit mund të lidhet me ndonjë ndryshim në njohuri dhe/ose qëndrime në raport me korrupsionin.

## 4. DINAMIKAT E PËRHAPJES SË KORRUPSIONIT 2014-2016

Ky kapitull analizon tendencat e përhapjes së korrupsionit dhe masat antikorrupsion për periudhën 2014-2016. Analizimi i kontekstit më të gjerë i shërben qëllimit të studimit, i cili është analizimi i korrupsionit policor, për shkak se faktorë të jashtëm si shkalla e korrupsionit në shoqëri, shkalla e tolerancës ndaj korrupsionit, masat antikorrupsion apo besimi në to dhe në institucione, janë faktorë që ndikojnë pozitivisht në korrupsionin policor.

Korrupsioni është përcaktuar si një ndër problemet kryesore të Shqipërisë që pengojnë zhvillimin dhe progresion ekonomik dhe shoqëror që prej rënies së regjimit komunist dhe gjatë gjithë periudhës së tranzicionit.

Matjet periodike të perceptimit të publikut mbi korrupsionin dhe studimet e kryera kanë treguar se shkalla e përhapjes së korrupsionit në Shqipëri është e lartë dhe korrupsioni është i pranishëm pothuajse në të gjitha nivelet dhe sektorët e veprimtarisë së shtetit.

Për shkak të problematikës së gjithëpranuar të korrupsionit dhe pasojave të tij edhe qeveria që erdhi në pushtet pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013 vendosi si prioritet luftën kundër korrupsionit.

Ndërmarrja e disa reformave dhe përmirësimi i disa treguesve ekonomikë dhe politikë dhanë rezultate, të cilat inkurajuan Bashkimi Evropian që t'i japë Shqipërisë statusin e vendit kandidat në vitin 2014. Raporti i progresit i BE-së i vitit 2014 nënvizonte se 'qeveria e re ka ndërmarrë një sërë reformash për ta sjellë vendin më afër realizimit të prioriteteve dhe për progresin drejt BE dhe dhënies së rezultateve më të prekshme, veçanërisht në drejtim të shtetit ligjor'.<sup>1</sup>

Megjithatë këto reforma nuk kanë kontribuar në mënyrë të ndjeshme në ndryshimin e situatës në lidhje me korrupsionin. Raport i BE për Shqipërinë 2015 nënvizonte se 'korrupsioni është i përhapur dhe se janë të nevojshme përpjekje më të mëdha për të krijuar rezultate të qëndrueshme


<sup>1</sup> Albania EU Progress report 2014, f.8

në hetimet, gjykimet dhe dënimet në të gjitha nivelet'.<sup>2</sup>

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International në Shqipëri edhe për periudhën 2014-2016 korrupsioni ka vazhduar të jetë i lartë dhe i përhapur në shkallë të gjerë duke bërë që vendi të vazhdojë të renditet ndër vendet më të korruptuara në Evropë për periudhën në fjalë.<sup>3</sup>

Në vitin 2015 Shqipëria arriti të ketë një klasifikim më të mirë, duke kapërcyer 22 vende dhe u rendit në vendin e 88, por me një rritje jo shumë të ndjeshme (nga 33 pikë në vitin 2014 ajo arriti të merrte 36 pikë nga 100 të mundshme). Kështu edhe në vitin 2015 Shqipëria ka arritur të lërë pas vetëm Kosovën dhe Moldavinë ndër vendet e rajonit të Evropës Juglindore dhe Qendrore.

Por duke mos e nënvleftësuar këtë rezultat, sfida mbetet ruajtja e trendit dhe qëndrueshmëria. Analizimi i tendencave të përhapjes së korrupsionit në Shqipëri që nga viti 2002 tregon se ka një lidhje të ngushtë midis rotacioneve politike dhe përhapjes së korrupsionit (shih grafikun 1).



**Grafiku 1.** Perceptimi i korrupsionit në Shqipëri për periudhën 2002-2015

Kështu, pas rotacionit politik të vitit 2005 reformat e qeverisë së asaj kohe shpunë në një rënie graduale të korrupsionit në tre vitet e para, duke shpënë në klasifikimin më të mirë historik të Shqipërisë në vitin 2008, që nga fillimi i Indeksit, por pas kësaj korrupsioni filloi të rritej përsëri.


<sup>2</sup> Albania EU Progress report 2015, f. 4

<sup>3</sup> Transparency International: Corruption Perceptions Index (2014) dhe Transparency International: Corruption Perceptions Index (2015)

Nga ana tjetër, matjet e Indeksit tregojnë se në vitet zgjedhore korrupsioni ka prirje të rritet në Shqipëri (24 pikë në vitin 2005 nga 25 në vitin 2004, 32 pikë në vitin 2009 nga 34 në vitin 2008, 31 pikë në vitin 2013 nga 33 në vitin 2012).

Për shkak se viti 2016 i ardhshëm është vit zgjedhor ekziston rreziku që për vitin në vazhdim dhe vitin e ardhshëm korrupsioni të shënojë rritje.

Edhe Freedom House e konsideron korrupsionin në Shqipëri si problemin kryesor për demokratizimin dhe integrimin e vendit në BE. Sipas vlerësimit të Freedom House, në periudhën 2014-2016 korrupsioni ka mbetur i pandryshuar, edhe pse në tre vitet e fundit ka pësuar një rënie të lehtë, krahasuar me vitet e mëparshme (*Grafiku 2*).<sup>4</sup>




**Grafiku 2.** Korrupsioni në Shqipëri sipas Freedom House

**Burimi:** Raportet e Freedom House, 'Nations in Transit', 2007, 2008, 2009, 2010, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016

Shqipëria ka vazhduar të renditet si vendi me presionin më të lartë të korrupsionit në rajon dhe për periudhën 2014-2016 ky presion ka shënuar rritje (*Grafiku 3*).<sup>5</sup>


4 Shkalla e vlerësimit të indeksit të korrupsionit të Freedom House është nga 1 (korrupsion i ulët) në 7 (korrupsion i lartë).

5 Ognian Shentov, Ruslan Stefanov, Boyko Todorov, 'Shadow Power: Assessment of Corruption and Hidden Economy in Southeast Europe'. SEDLI 2016 <http://seldi.net/publications/publications/shadow-power-assessment-of-corruption-and-hidden-economy-in-southeast-europe/>



**Grafiku 3.** Presioni i korrupsionit në vendet e Evropës Juglindore dhe tendencat për 2014 – 2016

Përsa i përket shpërndarjes, korrupsioni ka vazhduar të mbetet i përhapur në shkallë të lartë pothuaj në të gjithë degët e qeverisjes dhe sektorët kyç të vendit, edhe pse disa sektorë kanë shënuar një rënie në vitet e fundit (Grafiku 4). Fushat më problematike janë doganat dhe tatimet, gjyqësori, shëndetësia, arsimi, hipotekat, dhe qeverisja vendore.<sup>6</sup> Korrupsioni ka mbetur i lartë edhe ndër partitë politike, ministrat dhe deputetët.



**Grafiku 4.** Tendencat e përhapjes së korrupsionit sipas sektorëve, institucioneve dhe profesioneve për vitet 2010-2015

**Burimi:** IDRA, ‘Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja 2015-2016’

6 IDRA, ‘Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja 2015-2016’ <http://www.idrainstitute.org/files/reports/Corruption%202016/Gjetjet%20Kryesore%20Studimi%20i%20Korrupsionit%20IDRA%20Grafike.pdf>

## 5. VLERËSIMI I KUADRIT ANTI-KORRUPSION

Lufta kundër korrupsionit dhe lufta kundër krimit të organizuar janë ndër pesë prioritetet kyçe të cilat Shqipëria duhet t'i përmbushë në mënyrë që të vijojë më procesin e hapjes së negociatave për anëtarësim në BE.

Në këtë kontekst qeveria e re, me të ardhur në pushtet në vitin 2013 nisi një sërë reformash dhe masash për të luftuar korrupsionin në tërësi. Në këtë kuadër u rishikua dhe kuadri strategjik anti-korrupsion në nivel kombëtar dhe kuadri strategjik i Policisë së Shtetit.

Ky kapitull përpiqet të vlerësojë kuadrin strategjik dhe institucional dhe masat anti-korrupsion duke i analizuar ato sipas përshtatshmërisë, efikasitetit, efijencës, dhe qëndrueshmërisë.<sup>7</sup> Në këtë kuadër *përshtatshmëria* i referohet masës në të cilën masat anti-korrupsion janë të përshtatshme për të arritur objektivat në kontekstin ligjor institucional dhe politik të vendit. *Efikasiteti* i referohet masës në të cilën objektivat e përcaktuara janë arritur ose pritet të arrihen, duke marrë në konsideratë rëndësinë e tyre relative. *Efijenca* i referohet uljes në masë të konsiderueshme të korrupsionit me koston më të ulët, dhe *qëndrueshmëria* i referohet masës në të cilën masat antikorrupsion kanë krijuar rezistencë ndaj korrupsionit në nivel afatgjatë dhe kanë sjellë ndryshime në mënyrën se si zyrtarët publik e perceptojnë llogaridhënien.<sup>8</sup>

Nga analiza rezulton se përshtatshmëria, efikasiteti dhe efijenca janë të pjesshme ndërsa qëndrueshmëria mbetet ende sfidë pavarësisht rezultatit pozitiv të vitit 2015 të arritur në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International.<sup>9</sup>

### 5.1 STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015-2020

Dokumenti themelor i politikës shtetërore antikorrupsion është 'Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020' (SNKK) e miratuar nga Këshilli i Ministrave.<sup>10</sup>

SNKK është vijim i 'Strategjisë ndërsektoriale për parandalimin e luftën kundër korrupsionit dhe për një qeverisje transparente 2008-2013'. Për shkak të rotacionit politik Strategjia u miratua pas një periudhe boshllëku dy vjeçare.

7 Jeff Huther & Anwar Shah, "Anti-corruption Policies and Programs: A framework for Evaluation", Policy Research Working Paper 2501, World Bank, Washington, 2000

8 Po aty, f. 10-11

9 Transparency International: Corruption Perceptions Index (2015)

10 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 20.3.2015 Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020



Qasja	Objektivat
Parandaluese	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion</li> <li>2. Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore</li> <li>3. Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike</li> <li>4. Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit</li> <li>5. Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave</li> <li>6. Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike</li> <li>7. Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut</li> <li>8. Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion</li> <li>9. Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë</li> <li>10. Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit.</li> <li>11. Artikulimi dhe adoptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore</li> </ol>
Ndëshkimore	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit</li> <li>2. Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit</li> <li>3. Përmirësimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të korrupsionit</li> <li>4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër</li> </ol>
Ndërgjegjëse	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit</li> <li>2. Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit</li> <li>3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile</li> </ol>

**Tabela 5.** Qasja dhe objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale për Luftën kundër Korrupsionit kundër Korrupsionit 2015-2020

SNKK përcakton si vizion të saj *‘Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm.’*

Ashtu si edhe strategjia e mëparshme, SNKK përben një instrument politik shumëvjeçar, i cili ka për qëllimin të adresojë problemin e korrupsionit në të gjithë sektorët duke u bazuar në (1) parandalimin, (2) ndëshkimin, (3) ndërgjegjësimin.

Për secilën qasje SNKK përcakton objektiva specifike (*Tabela 1*).

Së bashku me strategjinë është miratuar dhe Plani i Veprimit i SNKK për periudhën 2015-2017. Planin e veprimit përcakton, aktivitetin, produktin, treguesit e zbatimit, sektorin që preket, institucionin përgjegjës dhe ato bashkëpunuese, afatin kohor dhe koston e produktit për secilin objektiv. Për zbatimin e Planit të Veprimit është parashikuar një buxhet prej rreth 12 milion Euro.

SNKK është parashikuar të zbatohet përmes koordinimit të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe mekanizmit mbikëqyrës dhe zbatues për strategjinë kundër korrupsionit.

Si tregues specifike për zbatimin e Strategjisë janë përcaktuar (1) përmbushja e treguesve specifike, të caktuar për çdo masë sipas Planit të veprimit; (2) numri i hetimeve dhe operacioneve proaktive dhe atyre me metoda speciale hetimi; (3) numri i kallëzimeve penale për vepra korrupsioni sipas metodologjisë për statistika të konsoliduara; (4) numri i dënimeve për vepra penale të korrupsionit.

SNKK dhe Plani i Veprimit parashikojnë që në vitin 2017 Shqipëria të arrijë nivelin e 37.5 pikëve në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International dhe në vitin 2020 të arrijë në nivelin e 40.5 pikëve.

Edhe pse rezultati i përmirësuar në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2015 është një arritje e rëndësishme, ruajtja e prirjes së uljes së korrupsionit për të arritur në nivelin e 40.5 pikëve në vitin 2020 ngelet sfidë.

Vetë zbatimi i SNKK ka ecur në mënyrë të ngadaltë. Për vitin 2015, nga 191 masat e parashikuara në Planin e Veprimit, janë zbatuar plotësisht 38 masa, 95 janë zbatuar pjesërisht dhe 52 nuk janë zbatuar.<sup>11</sup> Të ndara sipas tre qasjeve, për qasjen parandaluese janë zbatuar 28 masa, janë

<sup>11</sup> Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore. Raport Vjetor mbi Monitorimin dhe Zbatimin e Strategjisë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit 2015-2020. Mars 2016. f. 7

zbatuar pjesërisht 69, dhe 43 masa nuk janë zbatuar.<sup>12</sup> Në kuadër të qasjes ndëshkimore janë zbatuar 3 masa, 18 janë zbatuar pjesërisht dhe 4 masa nuk janë zbatuar.<sup>13</sup> Në kuadër të qasjes ndërgjegjësuese janë zbatuar 7 masa, 8 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 5 masa nuk janë zbatuar.<sup>14</sup>

Sfidat kryesore në zbatimin e SNKK janë: (1) burimet njerëzore dhe financiare të mangëta, si në realizimin e masave sipas parashikimeve ashtu dhe në raportimin e ecurisë së zbatimit; (2) konfuzioni i krijuar ndërmjet objektivave të Strategjisë dhe përmbushjes së funksioneve dhe detyrimeve ligjore rutinë të institucioneve; (3) niveli i ulët i angazhimit të i ulët për disa prej institucioneve të përfshira në zbatimin e Planit të Veprimit.<sup>15</sup>

Për pasojë gjatë periudhës 2014-2016 reformat nuk kanë arritur të trajtojnë një sërë problemesh themelore, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në legjitimitetin dhe efektivitetin e tyre siç janë, pavarësia politike e institucioneve, integriteti i tyre në menaxhimin e konfliktit të interesit, boshllëqet në standardet dhe normat e administratës dhe financimi jo transparent i partive politike.<sup>16</sup> Edhe realizimi i treguesve specifikë në lidhje me hetimin, gjykimin dhe dënimin e rasteve dhe personave të përfshirë në korrupsion ngelen të kufizuara.<sup>17</sup>

Nga ana tjetër, tendenca e përhapjes së korrupsionit në Shqipëri që nga viti 2002 tregon se ka një lidhje të ngushtë midis rotacioneve politike dhe shkallës së korrupsionit (shih grafikun 1). Kështu, pas rotacionit politik të vitit 2005 reformat e qeverisë së drejtuar nga Partia Demokratike (PD) sollën një rënie graduale të korrupsionit në tre vitet e para, duke shpënë në klasifikimin më të mirë historik të Shqipërisë në vitin 2008, që nga fillimi i Indeksit, por pas kësaj korrupsioni filloi të rritej përsëri. Po kështu, matjet e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit tregojnë se korrupsioni në Shqipëri ka prirje të rritet në vitet zgjedhore. Kështu, vendi ra në 24 pikë në vitin 2005, nga 25 në vitin 2004, dhe po kështu në 32 pikë në vitin 2009 nga 34 në vitin 2008 dhe në 31 pikë në vitin 2013, nga 33 në vitin 2012 (shih grafikun 1).

12 Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore. Raport Vjetor mbi Monitorimin dhe Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020. Mars 2016. f. 16 [http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages/Raport\\_Vjetor\\_mbi\\_Monitorimin\\_dhe\\_Zbatimin\\_e\\_Strategjis%C3%AB\\_Nd%C3%ABrsektoriale\\_kunder\\_Korrupsionit\\_20015-2020\\_.pdf](http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages/Raport_Vjetor_mbi_Monitorimin_dhe_Zbatimin_e_Strategjis%C3%AB_Nd%C3%ABrsektoriale_kunder_Korrupsionit_20015-2020_.pdf)

13 Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore. Raport Vjetor mbi Monitorimin dhe Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020. Mars 2016. f. 30

14 Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore. Raport Vjetor mbi Monitorimin dhe Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020. Mars 2016. f. 35

15 Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore. Raport Vjetor mbi Monitorimin dhe Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020. Mars 2016. f. 137-138

16 Transparency International. Vlerësim i Sistemit Kombëtar të Integritetit, Shqipëri 2016. [http://files.transparency.org/content/download/2031/13136/file/2016\\_NISAlbania\\_SQ.pdf](http://files.transparency.org/content/download/2031/13136/file/2016_NISAlbania_SQ.pdf)

17 Raporti i Progresit të BE-së 2015. f.55

## 5.2 STRATEGJIA E RENDIT PUBLIK 2015–2020

Plani i Veprimit i SNKK përcakton PSH si institucion përgjegjës për një sërë produktesh nën objektivat si: ‘Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit’, ‘Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit’, Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit.

Por dokumenti kryesor i PSH në luftën kundër korrupsionit policor është Strategjia e Rendit Publik 2015–2020 (SRP) dhe Plani i Veprimit 2015–2017 përbën dokumentin themelor strategjik të Policisë së Shtetit.<sup>18</sup>

SRP u miratua nga Këshilli i Ministrave dhe përbën dokumentin e dytë të këtij lloji pas Strategjisë së Policisë së Shtetit 2007-2013 (SPSH). Edhe miratimi i SRP nuk u realizua menjëherë mbas mbarimit të SPSH-së duke krijuar një periudhë vakumi dyvjeçare. Qëllimi i SRP është vlerësimi i zbatueshmërisë së ligjit në vend dhe përcaktimi i prioritetëve dhe objektivave për të përmirësuar standardet e sigurisë dhe për t’i përafruar ato me parametrat evropianë.

SRP paraqet si fillim një vlerësim të përgjithshëm të PSH dhe mjedisit ku ajo vepron, duke vënë theksin tek faktorë si pozita gjeografike, ekonomia, demografia, shkalla e integritit euroatlantik dhe tendencat e kriminalitetit.

Krahas trafikimit të lëndëve narkotike, krimeve të kryera me armë dhe lëndë plasëse, dhe trafikimit të qenieve njerëzorë, SRP e konsideron korrupsionin si një ndër kërcënimet me prioritet të lartë.<sup>19</sup> SRP gjithashtu e radhit korrupsionin si një ndër sfidat kryesore të PSH për të ardhmen.<sup>20</sup>

SRP përcakton si prioritete të PSH për periudhën 2015-2020: (1) zhvillimin dhe përafrimin e standardeve të PSH me ato të BE, (2) përforcimin e zbatimit të ligjit për ngritjen e nivelit të sigurisë, (3) luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, (4) menaxhimin e integruar i kufirit dhe i migracionit, dhe (5) përforcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar.

Ndërsa si objektiva strategjike SRP përcakton, (1) përafrimin e legjislacionit dhe të organizimit të PSH me atë të BE, (2) formimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë (3) përmirësimin e kushteve të

18 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 702, datë 26.8.2015, Për miratimin e Strategjisë së Rendit Publik 2015–2020 dhe të planit të veprimit 2015–2017. Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Numër 155, 2015

19 SRP, f.11147

20 SRP, f.11151

punës dhe teknologjisë, dhe (4) përsosjen e menaxhimit të brendshëm në PSH.

Objektivi i katërt, përsosja e menaxhimit të brendshëm në PSH, ka për qëllim specifik ‘që të ndryshojë niveli i menaxhimit e drejtimit brenda organizatës së Policisë, nëpërmjet njohjes e respektimit të rregullores së brendshme e akteve të tjera normative, si dhe zhvillimit të procesit të planifikimit, organizimit, drejtimit e kontrollit’.<sup>21</sup> Nën këtë objektivi, SRP nënvizon domosdoshmërinë e forcimit të integritetit, duke e vendosur theksin tek nevoja e vlerësimit në kompleks të faktorëve e shkaqeve që ndikojnë tek niveli i korrupsionit në Polici.

Masat që SRP parashikon për forcimin e integritetit dhe uljen e nivelit të korrupsionit në polici janë:

1. Kryerja e ndryshimeve organizative, të cilat do të vendosin instrumentet dhe procedurat e duhura ligjore e organizative dhe do të krijojnë mjedisin e duhur institucional për uljen e veprimeve korruptive.
2. Reformimi i sistemit të menaxhimit, i cili do të ndryshojë kulturën organizative, do të forcojë udhëheqjen në polici në të gjitha nivelet, do të zhvillojë mekanizmat llogaridhënës, forcojë integritetin dhe do të rrisë me tej besimin e mbështetjen e publikut ndaj policisë.
3. Ndryshimi i menaxhimit të burimeve njerëzore gjatë rekrutimit të punonjësve dhe promovimit në detyrë, duke qenë transparentë në bërjen e vlerësimeve të punës dhe zhvillimin e karrierës sipas vlerave e arritjeve në punë.
4. Promovimi i drejtuesve me cilësi të larta profesionale dhe personale dhe stilit të udhëheqjes në polici që angazhon e motivon të gjithë punonjësit për të zhvilluar integritetin e për të luftuar korrupsionin.
5. Institucionalizimi dhe zhvillimi i transparencës brenda Policisë dhe me publikun për gjithë veprimtarinë dhe treguesit e punës.
6. Ngritja e sistemit të ankimit të efektshëm për ti inkurajuar qytetarët të raportojnë sjelljen jo etike dhe korrupsionit në shërbimin policor.<sup>22</sup>

Krahas objektivave dhe prioriteteve të në PSH, në Planin e Veprimit të SRP parashtrihen masat, veprimtaritë konkrete, dhe instrumentet e vlerësimit për periudhën 2015 - 2017. Masat e parashikuara në Planin e Veprimit për përsosjen e menaxhimit të brendshëm në polici janë:

21 SRP, f.11155

22 SRP, f.11156

përmirësimi i sistemit të matjes së performancës; përmirësimi i sistemit të promovimit dhe avancimit në karrierë; dhe promovimi i punonjësve femra dhe përmirësimi i raporteve të përfaqësimit gjinor.<sup>23</sup>

Drejtoria e PSH është përgjegjëse për zbatimin e SRP. Monitorimi i zbatimit kryhet nëpërmjet raportimit vjetor tek Drejtori i PSH dhe Ministri i Brendshëm.<sup>24</sup>

Në kuadër të Planit të Veprimit të SNKK, një sërë produktesh për të cilat PSH është institucion përgjegjës për zbatimin e tyre janë zbatuar pjesërisht (Tabela 2).<sup>25</sup>

Produkti	Zbatuar
Kryerja e testimit të integritetit në Polici	Pjesërisht
Ngritja i sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes në të gjitha Komisaritet e Policisë	Pjesërisht
Pajisja e punonjësve të policisë rrugore dhe patrullës së përgjithshme me kamera vëzhgimi gjatë kryerjes së detyrave	Pjesërisht
Rritja e numrit të operacioneve me përdorimin e teknikave speciale të hetimit me 5% çdo vit; Rritja e numrit të hetimeve proaktive për korrupsion me 5% çdo vit	Pjesërisht

**Tabela 6.** Zbatimi i masave të parashikuara në Planin e Veprimit të SNKK për të cilat PSH është përgjegjëse

## 5.3 KUADRI LIGJOR

### 5.3.1 LIGJI PËR PSH

Ligji ‘Për Policinë e Shtetit’<sup>26</sup> është ligji bazë që rregullon veprimtarinë e PSH. Ligji u miratua në korrik të viti 2014 dhe shfuqizoi ligjin e miratuar në vitin 2007.<sup>27</sup> Ligji u ndryshua kryesisht me qëllim që të krijohet Byroja Kombëtare

23 SRP, f. 11185

24 SRP, f. 11166

25 Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore. Raport Vjetor mbi Monitorimin dhe Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020. Mars 2016

26 Ligj nr. 108/2014, datë 31.7.2014, ‘Për Policinë e Shtetit’

27 Ligji nr. 9749, datë 4.6.2007, ‘Për Policinë e Shtetit’

e Hetimit (BKH), e cila do të kishte për qëllim kryerjen e veprimtarisë gjurmuese dhe hetimore, për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe veprimtarinë kriminale të lidhur me të.<sup>28</sup> Por ngritja e BKH u hodh poshtë nga Gjykata Kushtetuese në vitin pasi binte ndesh Kushtetutën.<sup>29</sup>

Por ndryshimi i ligjit u motivua edhe për të trajtuar një sërë mangësish të vërejtura në ligjin e mëparshëm siç ishin hapësirat për keqinterpretim e moszbatim të përgjegjësive nga PSH; mundësitë për keqinterpretim të raporteve të Ministrit të Brendshëm me PSH; burokratizimi për shkak të ekzistencës së shumë niveleve të drejtimit; mangësitë në përcaktimin e përgjegjësive të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, drejtorive të policisë në qarqe dhe komisariateve të policisë; problemeve me sistemin e rregullimit të karrierës nëpërmjet gradave profesionale; mangësive në kriteret e pranimit në PSH, etj.<sup>30</sup>

Për të trajtuar këto mangësi ligji i ri e ristrukturon organizimin e PSH në katër nivele: (Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria vendore e policisë, Komisarjati i policisë, Stacioni i policisë);<sup>31</sup> ripërcakton rolin e Ministrit të Brendshëm si hartues dhe mbikëqyrës të zbatimit të politikave dhe kufizon ndërhyrjen e Ministrit në pavarësinë dhe drejtimin operacional të PSH;<sup>32</sup> ripërcakton ecurinë në karrierë nëpërmjet një sistemi gradash ku grada policore parashikohet si e drejtë e fituar nga punonjësi nëpërmjet procesit vlerësues e konkurrues.<sup>33</sup> Në drejtim të hapjes së PSH ndaj publikut, ligji e përcakton si detyrim të PSH për të informuar dhe bashkëpunuar me shoqërinë civile.<sup>34</sup>

### 5.3.2 LIGJI PËR SHËRBIMIN PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT

Ligji që lidhet drejtpërdrejt me luftën kundër korrupsionit në polici është Ligji “Për shërbimin për çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.<sup>35</sup> Me anë të këtij ligji, të miratuar në vitin 2014 dhe shfuqizimit të ligjit të mëparshëm,<sup>36</sup> Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm (SHKB) u transformua në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA).

28 Ligji për PSH, 2014, Neni 27

29 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendim nr.43 datë 26.06.2015

30 Relacion për Projektligjin ‘Për Policinë e Shtetit’ [https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/11/relacioni\\_per\\_policine\\_e\\_shtetit\\_17890\\_1.pdf](https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/11/relacioni_per_policine_e_shtetit_17890_1.pdf)

31 Ligji për PSH, 2014, Nenet 20-24

32 Ligji për PSH, 2014, Nenet 7-8

33 Ligji për PSH, 2014, Nenet 50-60

34 Ligji PSH, 2014. Neni 79

35 Ligj nr. 70/2014, datë 10.7.2014, ‘Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme’

36 Ligji nr. 10 002, datë 6.10.2008, ‘Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme’

Faktorët që shpunë në domosdoshmërinë e hartimit të ligjit të ri, sipas vetë SHKB, janë: nevoja për të ndërmarrë veprimtari hetimore duke u bazuar në elementë dhe metoda të hetimit proaktiv, jo vetëm duke u bazuar tek kallëzimet; mungesa për pasojë e produkteve antikorrupsion; pasaktësi dhe mangësi në ligj që krijonin hapësira dhe mundësi për interpretim.<sup>37</sup> Për shkak të ligjit të mëparshëm treguesit e punës të SHÇBA reflektonin ‘mungesë të theksuar efçence, ndikim të pamjaftueshëm në fushën e llogaridhënies policore, integritetit policor, parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe mospërfshirje të kontrollit të jashtëm qytetar ndaj saj’.<sup>38</sup>

Ligji i ri ka synuar t’i trajtojë këto mangësi në disa aspekte. Së pari, ligji zgjeron misionin e SHÇBA-së duke përfshirë garantimin e zbatimit të ligjit dhe interesave të publikut por edhe mbrojtjen nga veprimtari kriminale dhe të kundërligjshme.<sup>39</sup> Së dyti, ligji zgjeron objektin e veprimtarisë, ku përveç veprimtarive të parashikuara në ligjin e mëparshëm janë shtuar edhe: shqyrtimi i ankesave të publikut, ruajtja e integritetit të punonjësve, kontrolli i pasurisë së pajustificuar, goditja e veprimtarisë korruptive dhe kriminale, analiza, studimi dhe rekomandime të përgjithësuara mbi bazën e inspektimeve dhe hetimeve.<sup>40</sup> Përmirësime të tjera të ligjit përfshijnë ripërcaktimin e fushave të veprimit të veprimtarisë informative dhe hetimore; zgjerimin e kompetencave të inspektimit; detyrimin e strukturave të PSH për të marrë në konsideratë rekomandimet e bëra nga SHÇBA.

Në zbatim të ligjit të ri të SHÇBA-së, gjatë viti 2014 është rishikuar i tërë kuadri i akteve nënligjore që përfshin 4 vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe 12 urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrisë të Punëve të Brendshme.<sup>41</sup>

### 5.3.3 RREGULLORJA E PSH

Rregullorja e Policisë së Shtetit përbën një nga dokumentet themelore për PSH.<sup>42</sup> Edhe ky dokument është rishikuar në vitin 2015, në kuadër të ndryshimeve ligjore të ndërmarra në PSH gjatë tre viteve të fundit.

Qëllimi i rregullores është përcaktimi ‘i rregullave për organizimin dhe

37 Relacion mbi projektligjin ‘Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme, <http://shcba.gov.al/images/RELACION.pdf>

38 Relacion mbi projektligjin ‘Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme, <http://shcba.gov.al/images/RELACION.pdf>

39 Ligji për SHÇBA, 2014, Neni 4

40 Ligji për SHÇBA, 2014, Neni 5

41 Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Raporti Vjetor i Punës për Vitin 2014, <http://shcba.gov.al/images/Raporte/RPV2014.pdf>

42 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, Rregullore e Policisë së Shtetit



funksionimin e marrëdhënieve brenda dhe jashtë strukturave të policisë së shtetit; i parimeve, standardeve dhe normave që rregullojnë sjelljen profesionale dhe etike të punonjësit të policisë, gjatë dhe jashtë shërbimit; i ecurisë në karrierë dhe menaxhimit të burimeve njerëzore; i vlerësimit të performancës së strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe i rregullave për disiplinën dhe procedurave që ndiqen në rastin e shkeljeve disiplinore'.<sup>43</sup>

Ndryshe nga aktet e mëparshme rregullatore, të cilat ishin miratuar si dokumente të veçanta,<sup>44</sup> rregullorja e re përmbledh në një dokument të vetëm (1) rregullat e brendshme të PSH, (2) etikën e PSH, (3) ecurinë në karrierë, dhe (4) rregullat për disiplinën.<sup>45</sup>

Përmbledhja e rregullave në një dokument të vetëm përbën një mundësi më të mirë për komunikimin dhe njohjen me to të punonjësve të policisë pasi njohja e rregullave të organizatës është një nga elementet kyç për forcimin e integritetit, së bashku me mbështetjen për zbatimin e tyre, besimin tek ndershmëria e sistemit të disiplinës, dhe gatishmërinë për të raportuar rastet e keqsjelljes.<sup>46</sup>

Pjesa për rregullat e brendshme të PSH e Rregullores jep në mënyrë të detajuar organizimin dhe përgjegjësitë e strukturave të Policisë, rregullat e sjelljes në mjediset e punës, rregullat e përdorimit të armëve, rregullat e komunikimit si dhe rregullat për vlerësimin e performancës. Kapituj të veçantë në këtë pjesë i është dedikuar rregullave për hartimin e akteve administrative, planifikimit dhe analizës dhe policimit në komunitet.

Pjesa për etikën jep parimet e veprimtarisë së Policisë, standardet normat e sjelljes së punonjësve të policisë, dhe kontrollin dhe llogaridhënien për zbatimin e etikës.

Një e metë e kësaj pjese të rregullores është se e përcakton etikën si një normë detyruese për punonjësit e policisë më shumë se sa një kornizë për zbatimin e etikës si udhërrëfytes i praktikës policore në të gjitha nivelet.

Pjesa për ecurinë në karrierë, e cila është një rishikim i 'Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit',<sup>47</sup> përbën një nga pjesët më të rëndësishme të Rregullores, pasi proceset e rekrutimit në PSH, ecurisë në karrierë dhe largimit nga PSH kanë qenë vazhdimisht të diskutuara dhe të prekura nga korrupsioni dhe politizimi. Për pasojë ato kanë ndikuar negativisht si

43 Rregullore e PSH, Neni 1

44 Ligj Nr. 8291, datë 25.2.1998, Kodi i Etikës së Policisë; Vendim Nr. 786, Datë 4.6.2008, 'Për Miratimin e Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit; Vendim Nr. 804, Datë 21.11.2007 'Për Miratimin e Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit'.

45 Rregullore e PSH, Neni 2

46 Carl B. Klockars, Sanja Kutnjak Ivković, Maria R. Haberfeld. 'Enhancing police integrity'. Springer 2006. f.13

47 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 804, datë 21.11.2007, Për miratimin e rregullores së personelit të Policisë së Shtetit

në perceptimin e publikut për PSH ashtu edhe në besimin e punonjësve të policisë tek ndershmëria e këtyre proceseve (IDM 2014: f. 79-81).

Rregullorja ka përmirësuar procedurat e pranimit në PSH duke i bërë më të qarta dhe të detajuara këto procedura. Në të njëjtën mënyrë janë përmirësuar edhe procedurat e ecurisë në gradë, të transferimit dhe të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Kjo pjesë e rregullores parashikon gjithashtu edhe procedurat dhe kriteret për dhënie të stimujve për punonjës dhe struktura të PSH.

Pjesa për rregullat e disiplinës, e cila është rishikim i ‘Rregullores së disiplinës së Policisë së Shtetit’,<sup>48</sup> përcakton kategoritë e shkeljeve disiplinore, procedurat e raportimit dhe të hetimit, masat disiplinore, procedurat e ankimit dhe administrimit të tyre.

Kjo pjesë ka sjellë disa përmirësime në drejtim të saktësisimit të shkeljeve disiplinore duke përfshirë edhe përkufizimin e korrupsionit të kryer nga një punonjës policie,<sup>49</sup> i cili mungonte në rregulloren e mëparshme.

Në përgjithësi, rregullorja përbën një bazë të mirë në drejtim të forcimit të integritetit dhe frenimit të korrupsionit në PSH.

#### 5.3.4 MASAT ANTI-KORRUPSION

Përveç ndryshimeve ligjore dhe nënligjore gjatë periudhës së analizuar në këtë studim janë ndërmarrë dhe një numër masash, të cilat kanë synuar të trajtojnë problemin e korrupsionit në PSH.

Një masë e rëndësishme ka qenë krijimi i zyrave të shërbimit unik, siç njihen ndryshe edhe ‘zyrat me një ndalesë’, pranë komisariateve të policisë, të cilat duke ulur burokracinë dhe duke lehtësuar ndërveprimin e qytetarëve me policinë kontribuojnë në uljen e korrupsionit, kryesisht atij të vogël.

Në kuadër të masave për forcimin e integritetit u është rritur dy herë paga punonjësve të policisë,<sup>50</sup> dhe janë kryer investime për përmirësimin e kushteve të punës.

Një masë efektive për të parandaluar korrupsionin por dhe për të rritur transparencën është vendosja e kamerave në autopatrullat e policisë dhe kamerave të trupit për sektorin e kontrollit të trafikut rrugor.

Për të rritur transparencën ndaj publikut PSH bën publik buletin informativ në mënyrë periodike.

48 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 786, datë 4.6.2008 Për Miratimin e rregullores së disiplinës së Policisë së Shtetit

49 Rregullore e PSH, Neni 208.

50 Ministri Tahiri: Për Policinë e Shtetit rritje pagash me 17% prej Janarit 2017, <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/lajme/ministri-tahiri-per-policine-e-shtetit-rritje-pagash-me-17-prej-janarit-2017&page=1>

Për të raportuar rastet e korrupsionit SHÇBA ka rivendosur që prej vitit 2014 linjën e gjelbër (08009090) dhe ka instaluar aparaturën regjistruese të thirrjeve telefonike për të bërë të mundur ndjekjen e ecurisë së ankesave të publikut. SHÇBA ka krijuar dhe bërë publik gjithashtu Programin e Transparencës dhe ka emëruar një Koordinator për të Drejtën e Informimit.<sup>51</sup>

## 6. KUADRI INSTITUCIONAL

Megjithëse ka një dakordësi si nga publiku ashtu edhe nga institucionet vendëse dhe ndërkombëtare se korrupsioni është një nga sfidat kryesore me të cilat përballlet Shqipëria, nuk ka pasur ndonjë reagim për të fuqizuar kuadrin institucional më qëllim për ta trajtuar këtë sfidë në sa më mënyrë të përshtatshme.

Shqipëria nuk ka ende një agjenci të specializuar anti-korrupsioni të pavarur nga ekzekutivi, që t'i raportojë vetëm Parlamentit. Ashtu si në shumicën e vendeve të rajonit të Ballkanit, të cilat kanë pasur sukses në këtë drejtim, kjo agjenci duhet të ketë kompetenca për përpunimin e masave antikorrupsion, ndjekjen e zbatimit të tyre dhe mbi të gjitha hetimin në mënyrë të pavarur të rasteve të korrupsionit në të gjitha nivelet.<sup>52</sup>

Që nga viti 2013, qeveria i ka ngarkuar Ministrin të Shtetit për Çështjet Vendore detyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK). Por KKK e ka të vështirë të koordinojë me institucione që kanë pavarësi nga ekzekutivi, siç janë Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) apo Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH). Pranë Kryeministritë funksionon edhe Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion (NKBA), e cila ka kompetenca për të kryer hetime administrative dhe propozuar masa disiplinore dhe administrative në ministrinë dhe institucionet në varësi të Kryeministritë. Por roli i NKBA ka paqartësi dhe nuk përfshin parandalimin e korrupsionit.<sup>53</sup> Për pasojë, veprimtaria e KKK ka konsistuar kryesisht në hartimin Strategjisë Ndërsektoriale për Luftën kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe monitorimin e zbatimit të Planit përkatës të Veprimit 2015-2017.

Për më tepër, me gjithë kuadrin e fragmentuar institucional, nuk ka ndonjë

51 SHÇBA, Programi i Transparencës <http://shcba.gov.al/index.php/programi-i-transparences>

52 Agjenci të tilla janë: Agjencia Antikorrupsion në Serbi, Zyra e Prokurorit të Shtetit për Ndalimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Kroaci, Drejtoria Kombëtare e Antikorrupsionit në Rumani, etj.

53 Raporti i Progresit i BE-së 2015, f. 15

komision të specializuar antikorrupsion në Kuvendin e Shqipërisë, i cili do të kontribuonte për të zbutur fragmentimin e theksuar dhe konverguar veprimtarinë antikorrupsion të institucioneve respektive.

Përsa i përket kuadrit institucional antikorrupsion në PSH, ai është i përbërë nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili është i pavarur nga PSH dhe i raporton Ministrin të Punëve të Brendshme, dhe nga Drejtoria e Standardeve Profesionale (DSP), e cila është në varësi të Drejtorit të PSH.

SHÇBA është institucioni kryesor kundër korrupsionit në PSH.<sup>54</sup> Ky shërbim është i organizuar në nivel qendror dhe në nivel qarqesh (12 qarqe) dhe kryen dy funksione: hetimin e veprave penale (Departamenti i Kërkimit dhe Hetimit) dhe inspektimin (Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave) (Figura 3). Në këto dy vite SHÇBA është fuqizuar me shtesë personeli dhe aktualisht ka një staf prej 167 vetë nga 104 që kishte përpara tre vitesh (IDM 2014, f. 65). Megjithatë numri i inspektimeve të kryera nga SHÇBA konsiderohet i ulët<sup>55</sup> dhe rezultatet e hetimeve të korrupsionit pengohen nga mosmarrëveshjet mbi kompetencat, papërshtatshmëria e burimeve njerëzore dhe teknike dhe bashkëpunimi i dobët me prokurorinë.

Drejtoria e Standardeve Profesionale është struktura përgjegjëse për vlerësimin në vazhdimësi të performancës së strukturave qendrore dhe vendore të PSH.<sup>56</sup> Në përbushje të këtij funksioni DSP kryen vlerësime të vazhdueshme dhe propozon rekomandime strukturave përkatëse të PSH.<sup>57</sup> Në zbatim të Rregullores së PSH, DSP verifikon dhe heton shkelje disiplinore të kryera nga punonjës të PSH dhe propozon masat ndëshkuese.

DSP dhe SHÇBA bashkërendojnë veprimtarinë e tyre dhe në mënyrë periodike shkëmbejnë informacione në lidhje me hetimin e ankesave ndaj punonjësve të policisë.<sup>58</sup>

## 7. REZULTATET NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Në përgjithësi rezultatet e hetimeve dhe të dënimeve të rasteve të korrupsionit në Shqipëri kanë qenë të pjesshme dhe të pamjaftueshme. Edhe kur mediat kanë ekspozuar raste të korrupsionit të zyrtarëve të lartë

54 Struktura e SHÇBA, <http://shcba.gov.al/images/banners/Struktura.pdf>

55 Raporti i Progresit i BE-së 2015 f.54-55, 16-17

56 Rregullorja e PSH, Neni 96


57 Rregullorja e PSH, Neni 97, 102

58 Rregullore e PSH, Neni 218

apo të mesëm, hetimet serioze kanë munguar.<sup>59</sup> Në rastet kur ka pasur fillim të hetimeve të rasteve të tilla të korrupsionit ato nuk kanë ecur përpara për shkak të pamjaftueshmërisë së kapaciteteve, rrjedhjes së informacionit konfidencial, presionit politik dhe sistemit të fragmentuar.<sup>60</sup>

Hetimet financiare dhe konfiskimi i aseteve për raste të korrupsionit kanë qenë tepër të pakta për të dekuarajuar korrupsionin dhe ky i fundit është lehtësuar për shkak të depërtimit prej krimit të organizuar si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.<sup>61</sup>

Rezultatet e pakta në luftën kundër korrupsionit reflektohen edhe në besimin e ulët të publikut se korrupsioni mund të ulet. Shqipëria renditet si vendi me besimin më të ulët në rajon, përsa i përket besimit në efektshmërinë e luftës kundër korrupsionit (Grafiku 5).<sup>62</sup>



**Grafiku 5.** Presioni i korrupsionit në vendet e Evropës Juglindore dhe tendencat për 2014 – 2016

Një numër studimesh mbi korrupsionin policor nënvizojnë faktin se mjedisi i gjerë shoqëror, ekonomik dhe politik ndikon drejtpërsëdrejti në

59 Raporti i Progresit i BE-së 2015, f. 15

60 Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, 2015, fq. 16: <http://www.state.gov/documents/organization/253027.pdf>

61 Raporti i Progresit i BE-së Raporti i Progresit i BE-së 2015, f. 15-16

62 Ognian Shentov, Ruslan Stefanov, Boyko Todorov, 'Shadow Power: Assessment of Corruption and Hidden Economy in Southeast Europe'. SEDLI 2016, f. 19, <http://seldi.net/publications/publications/shadow-power-assessment-of-corruption-and-hidden-economy-in-southeast-europe/>

korrupsionin policor.<sup>63</sup>

Shërbimet policore janë të strukturuar në mjedisin shoqëror dhe roli institucional i tyre u krijon mundësinë punonjësve dhe strukturave të policisë që të përfshihen në korrupsion.<sup>64</sup> Jeta e shtrenjtë, pagat e ulta dhe mundësia për korrupsion i nxisin punonjësit e policisë të synojnë për përfitime financiare apo materiale nëpërmjet profesionit.

Edhe shkalla e lartë e përhapjes së krimit të organizuar ndikon në shtimin e rrezikut të policisë ndaj korrupsionit, pasi organizatat kriminale gjejnë mënyra për të ndërvepruar me policinë me qëllim përmbushjen e objektivave të tyre.<sup>65</sup>

Korrupsioni në sistemin e drejtësisë ka një ndikim të veçantë tek korrupsioni në polici, sepse padrejtësia dhe mungesa e efektivitetit të këtij sistemi i shtyn punonjësit e policisë drejt nënvleftësimit apo përçmimit të ligjit dhe tundimit për t'u përfshirë në korrupsion.

Por ndikimi i të gjithë këtyre faktorëve mund të jetë më i ulët, nëse funksionojnë me efikasitet kontrolli i korrupsionit dhe mekanizmat antikorrupsion në polici.<sup>66</sup> Kështu, dobësia e institucioneve antikorrupsion, pamjaftueshmëria e burimeve, kapaciteteve apo edhe e mbështetjes së nevojshme rrisin mundësitë për korrupsion në radhët e policisë.

Në grafikun më poshtë paraqitet trendi i rezultateve të SHKB/SHÇBA kundër korrupsionit dhe veprimtarisë antiligjore në PSH për periudhën 2006-2015 (Grafiku 6).

Siç shihet, në dy vitet e analizuar në këtë studim (2014-2015) ka pasur një rritje të konsiderueshme të aktivitetit anti-korrupsion, pasi numri i kallëzimeve, numri i punonjësve të policisë të kallëzuar për kryerje të veprave korruptive dhe antiligjore është rritur.

Krahas kësaj, gjatë vitit 2015, SHÇBA ka pasur prioritet parandalimin e korrupsionit,<sup>67</sup> çka mund të shpjegojë dhe rënien e numrit të kallëzimeve dhe numrit të punonjësve të policisë të kallëzuar, ndërkohë që ka pasur një rritje të numrit të punonjësve të arrestuar.


63 Maurice Punch, 'Rotten Orchards: "Pestilence", Police Misconduct and System Failure', Policing and Society 13, no. 2 (2003); Pierre Aepli, (Ed) 'Pakoja e Instrumenteve mbi Integritetin e Policisë', DCAF 2012; Sanja Kutnjak Ivkovic, 'Fallen Blue Knights: Controlling Police Corruption', Oxford University Press, Sep 30, 2005; Tim Prenzler, Police corruption: Preventing misconduct and maintaining integrity. CRC Press, Taylor & Francis Group 2009; Tim Newburn and Barry Webb. Understanding and preventing police corruption: lessons from the literature. No. 110. Home Office, Policing and Reducing Crime Unit, Research, Development and Statistics Directorate, 1999.

64 Pakoja 2012, f. 21

65 Newburn 1999, f. 21

66 Sanja Kutnjak Ivkovic, 'Fallen Blue Knights: Controlling Police Corruption', Oxford University Press, Sep 30, 2005, f. 64-94

67 Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Arritjet e Shërbimit gjatë vitit 2015, <http://sheba.gov.al/images/RVP2015.pdf>



Grafiku 6. Trendi i rezultateve të SHKB/SHÇBA për periudhën 2006-2015 kundër korrupsionit dhe veprimtarisë antiligjore në PSH.

Burimi: Raportet vjetore të SHÇBA, IDM 2014.


Përveç veprimtarisë antikorrupsion në PSH, SHÇBA gjatë vitit 2014 ka nisur procese disiplinore dhe ka dhënë masat përkatëse për 50 punonjës të SHKB-së (rreth 50% e personelit) si dhe ka larguar nga radhët e veta 13 punonjës.<sup>68</sup>

Megjithatë, analizimi i tendencave 10 vjeçare të veprimtarisë antikorrupsion të SHKB/SHÇBA-së tregon se ka një ndërlidhje ndërmjet rezultateve të veprimtarisë anti-korrupsion, dhe rotacioneve politike.

Siç mund të vërehet në Grafikon 6, numri i kallëzimeve dhe numri i punonjësve të policisë të kallëzuar për kryerje të veprave korruptive në vitet 2014-2015 ka qenë pothuajse po aq i lartë sa në dy vitet e para mbas ardhjes në pushtet të qeverisë së asaj kohe. Kjo ngjashmëri në tendenca, dhe vetë pretendimet e dy partive kryesore politike që kanë drejtuar vendin në këto dy periudha (2005-2013 dhe 2013-në vazhdim), tregojnë për natyrën e theksuar politike të luftës kundër korrupsionit në polici.

Përsa i përket hetimit të korrupsionit në raport me gradat policore, tendenca dominuese ka qenë vazhdimisht hetimi i korrupsionit ndaj punonjësve me grada të ulta. Kallëzimet ndaj punonjësve me grada të mesme kanë ardhur duke u ulur vazhdimisht që nga viti 2006, ndërsa në vitet 2013 dhe 2014 janë hetuar për korrupsion 4 drejtues të lartë policie (Grafiku 7).

68 Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Raporti Vjetor i Punës pr Vitin 2014, <http://shcba.gov.al/images/Raporte/RPV2014.pdf>



**Grafiku 7.** Shpërndarja e numri i kallëzimeve penale nga SHKB sipas pozicionit për periudhën 2006-2015.

**Burimi:** Raportet vjetore të SHKB/SHÇBA 2010-2015.

Ndërsa të dhënat nga sondazhet me publikun dhe punonjës të policisë tregojnë se korrupsioni është i përhapur edhe në strukturat e larta të PSH, mungesa e hetimeve në këto nivele tregon se zbatimi i masave antikorrupsion në këto nivele ka kufizime dhe pengesa.


Përveç masave ndëshkimore të marra nga SHÇBA edhe Drejtoria e Standardeve Profesionale ka trajtuar një numër të konsiderueshëm rastesh për shkelje disiplinore të kryera nga punonjësit e policisë dhe ka dhënë masa ndëshkimore (Grafiku 8).<sup>69</sup>

Siç shihet në grafikun më poshtë, ka pasur një tendencë mjaft të dukshme në rritje të praktikave disiplinore të ndjekura në tre vitet e fundit si dhe numrit të punonjësve të përjashtuar ose larguar nga PSH.<sup>70</sup>

69 Të dhënat për vitin 2016 janë deri në shtator të vitit 2016.

70 Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, tetor 2016.






**Grafiku 8.** Ecuria e praktikës disiplinore të hapura nga DSP për periudhën 2010-2016<sup>71</sup>

Përveç largimit nga PSH, DSP ka dhënë edhe një sërë masash të tjera sipas Rregullores së PSH-së si ulje në një gradë, ulje në detyrë më të ulët, pezullim pa pagesë, shtyrje e afatit të gradimit, vërejtje me paralajmërim, etj.

Ndryshe nga SHÇBA në rastin e masave të dhëna nga DSP ka një proporcion më të drejtë të shpërndarjes së masave sipas gradave (Grafiku 9).


Një tendencë pozitive vërehet në dy vitet e analizuara përsa i përket ndërveprimit të publikut me SHÇBA, pasi numri i ankesave dhe thirrjeve telefonike nga publiku në drejtim të SHÇBA-së është rritur dukshëm (Grafiku 10). Përveç ankesave, me vendosjen e linjës së gjelbër SHÇBA-së i janë drejtuar mijëra telefonata.

71 Raportet vjetore 'Mbi veprimtarinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm': 2010, 2011, 2012, 2013



**Grafiku 9.** Shpërndarja e masave të dhëna nga DSP sipas pozicioneve për vitin 2016.

**Burimi:** Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, Tetor 2016.




**Grafiku 10.** Numri i ankesave dhe telefonatave drejtuar SHÇBA për periudhën 2010-2015

**Burimi:** Raportet vjetore të SHKB/SHÇBA 2010-2015.

Një pjesë e konsiderueshme e ankesave kanë shërbyer për të nisur inspektime nga të cilat janë zbuluar një numër shkeljesh.

Gjatë vitit 2014 si rrjedhim i inspektimeve të nxitura prej ankesave të publikut është sugjeruar fillimi i procedurës disiplinore nga SHÇBA për 41 punonjës policie. Përveç këtyre SHÇBA ka sugjeruar fillimin e praktikës disiplinore për 112 punonjës policie në vijim të shkeljeve të gjetura gjatë inspektimeve.<sup>72</sup> Për vitin 2015 SHÇBA ka sugjeruar fillimin e praktikës disiplinore për 172 punonjës policie.<sup>73</sup>

Shtimi i numrit të ankesave të publikut drejtuar SHÇBA është shoqëruar me një rënie të graduale të numrit të ankesave drejtuar Avokatit të Popullit (AP) (Grafiku 11).



**Grafiku 11.** Ankesat e paraqitura ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit për periudhën 2012-2015 tek Avokati i Popullit.

**Burimi:** Raportet vjetore të institucionit të Avokatit të Popullit, 2012, 2013, 2014, 2015.

Megjithëkëtë, raportet e AP tregojnë se kultura e përdorimit të forcës fizike apo dhunës psikologjike nga punonjësit e policisë mbetet e përhapur në shkallë të konsiderueshme.<sup>74</sup>

Përdorimi i tepruar i forcës, keqtrajtimet dhe rrahjet gjatë marrjes në pyetje apo zgjatja e mbajtjes në arrest pa akuzë raportohen si probleme edhe në raportet vjetore mbi zbatimin e të drejtave të njeriut të Departamentit të Shtetit të SHBA.<sup>75</sup>

72 Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Raporti Vjetor i Punës pr Vitin 2014, <http://shcba.gov.al/images/Rapote/RPV2014.pdf>

73 Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Arritjet e Shërbimit gjatë vitit 2015, <http://shcba.gov.al/images/RVP2015.pdf>

74 Raport vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2014, <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/RAPORTI%202014.pdf> Raport vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2015, <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/03/Raporti-2015-avokati-i-popullit.pdf>

75 Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, 2014, <http://www.state.gov/documents/organization/236704.pdf>; Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, 2015, <http://www.state.gov/documents/organization/253027.pdf>

Përdorimi i pajustificuar i forcës konsiderohet si një nga format e korrupsionit, pasi kryhet duke përfituar nga pozita zyrtare e punonjësve të policisë. Gjithsesi, trajtimi i këtij problemi nuk zë ndonjë vend të rëndësishëm dhe nuk pasqyrohet në raportet e SHÇBA-së.

## 8. KORRUPSIONI POLICOR

Në mënyrë të përmbledhur Raporti për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri i Departamentit Amerikan të Shtetit i vitit 2015 e përshkruan si më poshtë zbatimin e ligjit dhe korrupsionin në polici në Shqipëri:

*‘Policia nuk ka e ka zbatuar gjithmonë ligjin në mënyrë të barabartë. Lidhjet personale, politike ose kriminale, infrastruktura e dobët, mungesa e pajisjeve, ose mbikëqyrja e pamjaftueshme janë ato që shpesh kanë ndikuar në zbatimin e ligjeve. Pagat e ulëta, motivimi dhe lidhshipi i dobët, dhe mungesa e diversitetit mes punonjësve të policisë kanë kontribuar në korrupsionin e vazhdueshëm dhe sjelljen joprofesionale’.*<sup>76</sup>

Studimi mbi korrupsionin policor ‘Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri’,<sup>77</sup> i kryer dy viteve më parë, vuri theksin tek disa nevoja e ndërlihdhjes ndërmjet shkaqeve të korrupsionit dhe korrupsionit aktual duke nënvizuar se korrupsioni policor ka natyrë organizative dhe zbatimin i masave për hetimin dhe dënimin e korrupsionit duhet të kombinohet me forcimin e kulturës së integritetit. Kjo pasi studimi tregoi se ndërtimi i mekanizmave antikorrupsion mbi premisën se shkak i korrupsionit janë punonjës të veçantë të policisë nuk shpie në forcimin e integritetit policor dhe se integriteti i dobët i organizatës së policisë përbën premisë për më shumë korrupsion.

Siç e thekson edhe Raporti për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri i Departamentit Amerikan të Shtetit, korrupsioni dhe sjellja joprofesionale e punonjësve të policisë kanë vazhduar edhe gjatë viteve në vijim, me gjithë përpjekjet e bëra për t’i luftuar ato.

Në këtë kapitull analizohen (1) shkalla e përhapjes së korrupsionit policor në Shqipëri: në përgjithësi, sipas llojeve të korrupsionit, sipas niveleve të menaxhimit, sipas strukturave dhe pozicionit; (2) shkaqet e korrupsionit

<sup>76</sup> Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, 2015, <http://www.state.gov/documents/organization/253027.pdf>

<sup>77</sup> Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri 2014


(3) besimi tek masat antikorrupsion.

Analiza bazohet kryesisht në të dhëna të mbledhura nga sondazhe të kryera me publikun dhe me punonjës të policisë gjatë muajit qershor dhe korrik 2016. Në analizë përfshihen edhe të dhënat e të njëjtave sondazhe të kryera gjatë muajit janar-mars 2014, të cilat janë përdorur kryesisht për të parë prirjet duke u mbështetur në të dy palët e të dhënave.

## 8.1 DINAMIKAT E PËRHAPJES SË KORRUPSIONIT POLICOR

Një nga vështirësitë e adresimit të korrupsionit policor në Shqipëri është mungesa e studimeve mbi këtë fenomen dhe problem shoqëror. Të dhënat mbi korrupsionin policor për mbi dy dekada janë marrë nga sondazhe me publikun por kryesisht të bazuara mbi krahasimin me profesione të tjera dhe mbi ryshfetin.

Sipas sondazhit të kryer me të njëjtat pyetje, në vitin 2014 dhe 2016, për herë të parë jepet një pamje e tendencave përhapjes së korrupsionit policor në Shqipëri për një hark të caktuar kohe (Grafiku 12). Shihni Shtojcën 1 për të dhënat e plota mbi pyetjet dhe rezultatet e sondazhit 2016 me publikun.




**Grafiku 12.** Shkalla e përhapjes së korrupsionit në PSH për vitet 2014 dhe 2016.

Siç shihet, korrupsioni policor vazhdon të mbetet në nivele të larta në PSH dhe ka shënuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2014.

Me gjithë luhatjet dhe pavarësisht qasjeve metodologjike për matjen e tij

në 15 viteve të fundit, të dhënat e fundit tregojnë se korrupsioni policor në Shqipëri vazhdon të mbetet një problem i qëndrueshëm (Grafiku 13). Kjo qëndrueshmëria në përhapjen e korrupsionit në PSH tregon se korrupsioni përbën tashmë një tipar të theksuar të kulturës policore në Shqipëri dhe se trajtimi në mënyrë po të qëndrueshme i këtij problemi do të kërkojë kohë dhe përqendrim të vazhdueshëm të përpjekjeve dhe burimeve.



**Grafiku 13.**<sup>78</sup> Shkalla e përhapjes së korrupsionit policor në Shqipëri bazuar në të dhëna nga sondazhe të SELDI-t (2001, 2002),<sup>79</sup> IDRA-s (2005, 2008, 2009, 2015)<sup>80</sup>, Transparency International (2013)<sup>81</sup> dhe IDM-së (2014, 2016).

## 8.2 PËRHAPJA E KORRUPSIONIT SIPAS NIVELEVE TË MENAXHIMIT POLICOR

Për të vlerësuar përhapjen e korrupsionit sipas niveleve të menaxhimit policor publiku është pyetur të japë mendimin e vet për pesë nivele: niveli drejtues i lartë në Drejtorinë e PSH, niveli i lartë i drejtuesve të PSH në

78 Vlerat 51% dhe 55% e nxjerrë nga sondazhet e IDM është agregat i vlerave ‘Është i përhapur në një masë të konsiderueshme’ dhe ‘Është mjaft i përhapur dhe serioz’


79 Vitosh Research, ‘Corruption Indexes, Regional Corruption Monitoring in Albania, Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Macedonia, Romania, and Yugoslavia’. Vitosh Research - International Research. April 2002. [http://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/Corruption\\_Indexes\\_2002.PDF](http://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/Corruption_Indexes_2002.PDF)

80 Instituti për Kërkime dhe Alternative Zhvillimi, IDRA. ‘Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja’ Sondazhi 2005; Instituti për Kërkime dhe Alternative Zhvillimi, IDRA. ‘Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja’ Sondazhi 2008; Instituti për Kërkime dhe Alternative Zhvillimi, IDRA. ‘Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja’ Sondazhi 2009; Instituti për Kërkime dhe Alternative Zhvillimi, IDRA. ‘Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja’ Sondazhi 2015-2016

81 Global Corruption Barometer, 2013. <https://www.transparency.org/gcb2013/country/?country=albania>

nivel qarku, niveli drejtues në komisariate, niveli i mesëm në komisariate dhe niveli bazë i punonjësve të policisë.

Në vitin 2016 janë bërë të njëjtat pyetje gjatë kryerjes së sondazheve si në vitin 2014. Rezultatet e sondazheve tregojnë një tendencë në rritje në përgjithësi të korrupsionit në të gjitha nivelet në vitin 2016, por kjo prirje është më e madhe për nivelet e larta drejtuese të PSH (Grafiku 14).




**Grafiku 14.** Përhapja e korrupsionit sipas niveleve të menaxhimit policor

Rezultatet e të dhënave tregojnë për një rritje të përhapjes së korrupsionit në nivelet e larta drejtuese të PSH dhe një rritje, e cila sa vjen e bëhet më e ulët për nivelet e tjera, deri në nivelin bazë.

Ajo që vihet re nga rezultatet në grafikun më sipër është disproporcioni ndërmjet perceptimit të publikut për përhapjen e lartë të korrupsionit më shumë në nivelet e larta se në ato të ulta dhe hetimit të korrupsionit nga SHÇBA dhe DSP ku të hetuarit dhe dënuarit për korrupsion janë në masë dërmuese të nivelit zbatues dhe drejtues të ulët e të mesëm (Grafiku 7 dhe 9).


Edhe përsa i përket përhapjes së korrupsionit sipas strukturave apo shërbimeve të ndryshme të Policisë, tendenca e përgjithshme është në rritje krahasuar me vitin 2014 (Grafiku 15). Një rënie të konsiderueshme me 21% vërehet për Policinë Rrugore, ndërkohë që rritje e ndjeshme vërehet për Antikrimin Financiar dhe Antinarkotikët.



**Grafiku 15. Përhapja e korrupsionit sipas strukturave/shërbimeve të Policisë**

Rasti i rënies së perceptimit për korrupsionin në Policinë Rrugore vlen për t’u veçuar, sepse duke qenë se ka pasur korrupsion të lartë ky sektor i PSH është vënë dhe në qendër të masave për zbutjen e tij. Këto masa kanë dhënë rezultat të dukshëm.

Përsa i përket SHÇBA, ka një qëndrueshmëri të perceptimit të publikut për shkallën e përhapjes së korrupsionit, por ka një rritje prej 4% të atyre që mendojnë se korrupsioni në këtë shërbim është mjaft i përhapur (Grafiku 16).



**Grafiku 16. Korrupsioni në SHÇBA**



### 8.3 PËRVOJAT ME KORRUPSIONIN


Përsa i përket përvojave personale me korrupsionin policor, vetëm 32% e të pyeturve raportojnë të kenë pasur kontakt me ndonjë punonjës policie gjatë vitit të fundit, ndërsa 15% kanë pasur kontakt më herët. 18% e të pyeturve deklarojnë se u është kërkuar ryshfet gjatë vitit të fundit nga Policia rrugore dhe 17% e tyre deklarojnë se i kanë dhënë ryshfet një punonjësi Policisë Rrugore. Një numër më i vogël, 7% dhe 8%, pohojnë se u janë kërkuar dhe kanë dhënë ryshfet dhe favore nga Policia Rrugore. Nga ana tjetër, rastet e kërkimit dhe dhënies së ryshfetit apo favoreve nga shërbime të tjera policore janë më të pakta. 1% apo 2% e të pyeturve pohojnë se kanë pasur eksperiencën të tilla me Antidorgën, Policinë e Kufirit, dhe Policinë e Rendit.

Nga ata që kanë raportuar se kanë pasur eksperiencën të tilla 89% deklarojnë se punonjësit e policisë e kanë pranuar ryshfetin apo favorin dhe vetëm 11% deklarojnë se nuk u është pranuar ryshfeti apo favori nga punonjësi i policisë.

Siç duket nga kjo e dhënë, shkalla e rezistencës së PSH ndaj presionit të korrupsionit mbetet e ulët, çka do të thotë se dhe efektiviteti i masave parandaluese vazhdon të jetë i ulët.

Nga ana tjetër, shkalla e angazhimit të qytetarëve për të denoncuar korrupsionin vazhdon të jetë e ulët. Edhe pse 65% e të pyeturve thonë se dinë se ku mund të denoncojnë një akt ose tentative korrupsioni të punonjësve të policisë, shifër që është 10% më e lartë se në vitin 2014, 95% e tyre pohojnë se nuk e kanë kryer një akt të tillë (Grafiku 17).

Përveç atyre që thonë se nuk kanë pasur kontakt me policinë (52%), nga ata që kanë pasur një rast të tillë 12% thonë se e kanë pasur më të lehtë të zgjidhin problemin nëpërmjet ryshfetit, 19% e tyre pohojnë se nuk kanë denoncuar pasi nuk kanë besim tek institucioni ku do të denonconin, ndërsa 5% se nuk e kanë bërë për arsye të mungesës së kohës për t'u marrë me këtë procedurë.



### **Grafiku 17. Përvojat me korrupsionin**

Një tregues pozitiv është shtimi i numrit të qytetarëve të informuar se ku mund të denoncojnë korrupsionin falë fushatave sensibilizuese dhe përmirësimit të infrastrukturës së marrjes së denoncimeve nga SHÇBA dhe vetë PSH, por dhe hapjes së portalit [stopkorrupsionit.al](http://stopkorrupsionit.al).

Më shumë sesa nga përvojat personale, qytetarët duket se e formojnë opinionin e tyre mbi korrupsionin në polici nëpërmjet mjeteve të informimit publik. Në të dy sondazhet, mbi 70% e të pyeturve deklarojnë se informohen për korrupsionin policor nga mediat, familjarët dhe të njohurit, ndërsa vetëm 8% e të pyeturve në vitin 2016 dhe 5% e të pyeturve në vitin 2014 kanë deklaruar se kanë formuar opinionin e tyre mbi përvojat personale.

Predominimi gjerësisht i medias në marrjen e informacionit mbi korrupsionin nga publiku tregon për rolin e rëndësishëm që ka media si për të komunikuar arritjet pozitive të Policisë ashtu edhe për të formësuar opinion mbi korrupsionin në Polici nëpërmjet jehonës që i bëhet rasteve të korrupsionit.

## **8.4 PËRHAPJA E KORRUPSIONIT SIPAS LLOJEVE**

Sipas raporteve të SHÇBA, llojet më të përhapura të korrupsionit për të cilat janë kryer hetime dhe hapur çështje penale përfshijnë korrupsionin

pasiv, trafikimin apo kultivimin e narkotikëve, falsifikim të dokumenteve zyrtare, vjedhje, trafik të mjeteve motorike, përfshirje në shfrytëzim prostitucioni, etj.

Vendosja e theksit mbi llojet e korrupsionit dhe përhapjen e korrupsionit sipas llojeve në këtë studim është bërë për t'i ardhur në ndihmë institucioneve antikorrupsion në vlerësimin e rrezeve ndaj korrupsionit dhe marrjen e masave të përshtatshme anti-korrupsion.

Në këtë këndvështrim pyetjet që iu janë drejtuar qytetarëve kanë synuar të japin një pamje të përhapjes së korrupsionit sipas formave dhe llojeve duke pasur parasysh tipologjitë e korrupsionit policor. Kështu, pyetjet synojnë të marrin perceptimet e publikut mbi format e transaksioneve korruptive, që mund të jenë para, dhurata apo favore, të formave të korrupsionit nëpërmjet përfshirjes në vepra kriminale, të korrupsionit që cenon burimet dhe fondet publike apo shkel rregullat e brendshme të institucionit të policisë ose ligjet, përfshirë dhe korrupsionin politik. Po kështu, pyetjet synojnë të mësojnë se sa është reagimi ndaj një korruptuesi të jashtëm apo proaktiv, kur punonjësit e policisë i krijojnë vetë kushtet për të përfituar nëpërmjet korrupsionit.


Këto të dhëna synojnë të krijojnë një pamje të problemit të korrupsionit sipas llojeve, porë nëpërmjet perceptimit të qytetarëve, por edhe për të hedhur dritë mbi masat parandaluese që mund të ndërmerren.

Nga format e transaksioneve korruptive, ryshfeti (dhënia e parave në këmbim të një shërbimi) është forma më e përhapur dhe mbetet pothuajse i pandryshuar në të dy vitet që është matur (Grafiku 18).<sup>82</sup> Predominimi i ryshfetit si formë transaksioni korruptive, mbetet forma më e përhapur në Shqipëri krahasuar edhe me vendet e rajonit (përveç Kosovës) në të cilat mbizotëron dhënia e dhuratave si forma më e përhapur.<sup>83</sup>

Përsa i përket favoreve, ka një rritje të ndjeshme në këto dy vite të numrit të qytetarëve të cilët mendojnë se policët ofrojnë favore për të tretët, pra persona jashtë shërbimit policor, që mund të tregojë se edhe në Shqipëri ka një prirje për të përdorur favorët si formë transaksioni korruptive. Një rritje të dukshme ka edhe shpërdorimi i fondeve të Policisë.

82 Në grafik janë pasqyruar shumica e përqindjeve të përgjigjeve të qytetarëve që kanë pohuar se janë 'dakord' dhe ata 'plotësisht dakord' me pyetjen.

83 Ognian Shentov, Ruslan Stefanov, Boyko Todorov, 'Shadow Power: Assessment of Corruption and Hidden Economy in Southeast Europe'. SEDLI 2016. f. 18 <http://seldi.net/publications/publications/shadow-power-assessment-of-corruption-and-hidden-economy-in-southeast-europe/>




**Grafiku 18. Përhapja e korrupsionit sipas formave të transaksionit dhe llojeve**


Më serioze paraqiten tendencat në lidhje me përhapjen e llojeve më të rënda të korrupsionit. Numri i qytetarëve që pohojnë se punonjësit e policisë bashkëpunojnë me njerëz të inkriminuar dhe/ose me organizata kriminale është rritur me 27%, krahasuar me vitin 2014, me 24% i atyre që pohojnë se punonjësit e policisë janë të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme si trafikë, kontrabande, etj. Po ashtu, është rritur ndejshëm edhe numri i atyre që pohojnë se punonjësit e policisë manipulojnë provat, 20% më shumë se në vitin 2014, dhe e atyre që mendojnë se prokurimet në polici kryhen në mënyre korruptive, 23% më shumë se në vitin 2014 (Grafiku 19).

Një rënie të lehtë (1%) ka në numrin e atyre që pohojnë se punonjësit e policisë që punojnë në terren janë më të korruptuar se ata që punojnë në zyra, çka vë në pah mospërputhjen ndërmjet numrit të lartë të punonjësve të rangjeve të ulta të dënuar për korrupsion dhe perceptimit të publikut se korrupsioni është i përhapur më shumë atje ku kompetencat janë dhe më të mëdha, pra në rangjet më të larta.

Edhe përsa i përket përhapjes së korrupsionit administrativ dhe atij politik ka një rritje të ndjeshme të qytetarëve që pohojnë se këto lloje korrupsioni janë të përhapura. Rritja më e madhe është tek numri i qytetarëve, 23%, që pohojnë se drejtuesit politikë e përdorin policinë për qëllime korruptive



**Grafiku 19.** Përhapja e korruptionit sipas llojeve



**Grafiku 20.** Përhapja e korruptionit administrativ dhe politik

dhe i atyre që pohojnë se për të kryer korruptionin drejtuesit politikë dhe punonjësit e policisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre, 19% (Grafiku 20).


Po kështu, është shtuar numri i qytetarëve që mendojnë se rekrutimet, emërimet dhe gradimet, janë korruptive. Në këtë kategori më i lartë është numri i qytetarëve (17%) që pohojnë se emërimet dhe gradimet në nivelet e larta të policisë janë korruptive.

### 8.5 SHKAQET E KORRUPSIONIT

Për të mësuar mbi shkaqet e korrupsionit, pyetjet që iu janë drejtuar publikut janë ndarë në dy kategori: në pyetje që synojnë të marrin përgjigje për shkaqet të jashtme, pra të atyre shkaqeve që nuk kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me institucionin apo organizatën e policisë, dhe në pyetje që synojnë të marrin përgjigje për shkaqe të brendshme, të cilat burojnë apo gjenden brenda institucionit apo organizatës.

Për shkaqet e jashtme janë bërë pyetje që lidhen me përhapjen e korrupsionit në institucionet kryesore të shtetit, besimi tek këto institucione në luftën kundër korrupsionit, dhe ndikimi i faktorëve të tillë të jashtëm, si presioni politik, toleranca e shoqërisë ndaj korrupsionit dhe angazhimi i publikut në luftën kundër korrupsionit.

Siç shihet nga grafiku më poshtë, përhapja e korrupsionit në institucione të shtetit sipas qytetarëve është e lartë dhe prirja e përgjithshme është rritja në krahasim me vitin 2014. I vetmi institucion i cili nuk ka pësuar ndryshim me dy vite më parë është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (Grafiku 21).




**Grafiku 21.** Përhapja e korrupsionit në institucione të larta të shtetit

Një rritje të ndjeshme ka në numrin e qytetarëve, të cilët mendojnë se korrupsioni është shtuar tek institucionet e Parlamentit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme dhe Presidentit, por qytetarët perceptojnë si institucionet më të korruptuara Gjykatat dhe Prokurorinë.

Rritja e shkallës së perceptimit të përhapjes së korrupsionit shoqërohet me një rënie të ndjeshme të besimit. Ndaj pyetjes sa ‘sa besim keni se do të luftojnë korrupsionin në polici institucionet’, e paraqitura në grafikun 22, nga përgjigjet rezulton se krahasuar me vitin 2014 ka një rënie të theksuar të besimit të qytetarëve tek të gjitha institucionet, përveç SHÇBA (Grafiku 22).

Institucionet të cilat shënojnë rënie më të madhe të besimit janë Ministria e Brendshme me 19%, Drejtori Përgjithshëm i PSH me 17% dhe Kryeministri me 10%, edhe pse krahasuar me institucionet e tjera këto institucione vazhdojnë të gëzojnë një besim më të lartë.

Besimi tek Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Prokurori i Përgjithshëm gjithashtu ka rënë me 6% dhe 7% respektivisht.




**Grafiku 22.** Besimi në luftën ndaj korrupsionit nga institucione të larta të shtetit

Faktor me ndikim në korrupsionin e lartë policor nga qytetarët konsiderohet ‘ndikimi i tepruar i politikës në polici’, për të cilin 48% e të pyeturve mendojnë se ka ‘shumë’ ndikim. Po kështu 46% e të pyeturve mendojnë se toleranca e publikut ndaj korrupsionit dhe angazhimi i pamjaftueshëm i publikut kundër korrupsionit kanë gjithashtu ‘shumë’ ndikim.

Për t’u informuar mbi perceptimet e publikut për shkaqet e brendshme

të korrupsionit janë bërë pyetje që kanë synuar të marrin përgjigje mbi aspekte të tilla si, qëndrimi i niveleve menaxhuese ndaj korrupsionit, niveli i pagave dhe kushtet e punës së punonjësve të policisë, cilësia e trajnimit apo menaxhimi policor. Më tej qytetarëve janë pyetur për të bërë një vlerësim të kuadrit anti-korrupsion për të parë se sa i përshtatshëm është ky kuadër dhe sa zbatohet ai.

Të dhënat e përftuara nga përgjigjet tregojnë se kultura organizative e PSH është ajo e tolerancës dhe e mosveprimit ndaj korrupsionit, kulturë që buron nga nivelet e larta menaxhuese të organizatës. Krahasuar me vitin 2014 është shtuar numri i qytetarëve që pohojnë se nivelet e larta drejtuese të policisë e tolerojnë korrupsionin për shkak se ata janë vetë të korruptuar. Po kështu është shtuar numri i qytetarëve që mendojnë se duke mosvepruar ndaj korrupsionit, drejtuesit e policisë kontribuojnë në dekuarjimin e anti-korrupsionit dhe në nxitjen e punonjësve të policisë që të përdorin pozicionin e tyre për qëllime korruptive. Kështu, numri i qytetarëve që mendojnë se punonjësit e policisë janë të motivuar për ta zbatuar ligjin mbetet i ulët pavarësisht një rritjeje të lehtë (Grafiku 23).



**Grafiku 23.** *Kultura e anti-korrupsionit në menaxhimin e PSH*


Prania e kulturës së korrupsionit si tipar organizativ del në pah edhe nga përgjigjet e qytetarëve ndaj pyetjes nëse ‘punonjësit e policisë janë të korruptuar që para se të hyjnë në radhët e Policisë’. Plot 43% e tyre nuk



janë dakord me këtë pohim dhe vetëm 32% rakordojnë më këtë pohim, çka tregon se qytetarët mendojnë se punonjësit e rinj të policisë korruptohen kur hyjnë në radhët e Policisë. Kjo përputhet edhe me përgjigjet ndaj pyetjes nëse ‘punonjësit më të vjetër të policisë janë më të korruptuar sesa ata të rinj’: 55% e tyre janë ‘dakord’ ose ‘plotësisht dakord’ me këtë pohim ndërsa vetëm 29% nuk janë dakord.

Një tjetër tipar i kulturës së korruptionit është ndërlidhja ndërmjet korruptionit dhe gjinisë. Rreth 67% e të pyeturve pohojnë se ‘punonjësit meshkuj të policisë janë më të korruptuar sesa punonjëset femra’ ndërsa vetëm 14% e tyre thonë se nuk janë dakord me këtë.

Një e dhënë tjetër që vë theksin tek kultura e integritetit si mjet anti-korrupsioni është dinamika në përgjigjet e dhëna në lidhje me kushtet e punës dhe pagat. Krahasuar me vitin 2014, ka një rënie të numrit të qytetarëve që mendojnë se shkalla e korruptionit në polici ndikohet nga pagat e ulta, kushtet e këqija të punës apo trajnimi i dobët. Ka një rritje të dukshme, 14% krahasuar me vitin 2014, të numrit të qytetarëve që mendojnë se shkalla e korruptionit lidhet me kulturën e punës në institucionin e policisë (Grafiku 24).



**Grafiku 24.** Ndikimi i pagave dhe kushteve të punës e trajnimit në korruptionin policor


Po kështu, 52 % e të pyeturve mendojnë se menaxhimi i dobët i policisë është faktor ndikues në korruptionin policor.<sup>84</sup>

Përsa i përket zbatimit të kuadrit për parandalimin e korruptionit, vetëm

84 Pyetja sa ndikon menaxhimi i dobët i policisë tek shkalla e korruptionit është shtuar në pyetësorin e vitit 2016 dhe për këtë arsye nuk ka krahasim me vitin 2014.

4% e të pyeturve mendojnë se ky kuadër zbatohet plotësisht, dhe po 4% mendojnë se kuadri ligjor për hetimin e korrupsionit zbatohet plotësisht. Rreth 36% mendojnë se kuadri për parandalimin e korrupsionit zbatohet ‘deri diku’ ndërsa 41% mendojnë në këtë mënyrë për kuadrin ligjor për hetimin e korrupsionit.


Të gjithë këta faktorë duket se kanë ndikuar dhe në rënien e besimit të përgjithshëm se korrupsioni në polici mund të ulet. Kështu, është rritur me 12% numri i qytetarëve që përgjigjen se korrupsioni në polici është i pamundur që të zvogëlohet dhe me 15% numri i atyre që mendojnë se është plotësisht e mundur që korrupsioni të të zvogëlohet (Grafiku 25)



**Grafiku 25.** Besimi se korrupsioni në polici mund të zvogëlohet

Po ashtu, është rritur me 12% numri i qytetarëve që mendojnë policia mund të luftojë korrupsionin brenda vetes. Në këtë drejtim, ka një rënie prej 12% të numrit të qytetarëve që mendojnë se kjo gjë është ‘plotësisht e mundur’ dhe një rritje të atyre që mendojnë se është e pamundur. Nga ana tjetër, duket se pritshmëritë e qytetarëve janë zhvendosur në drejtim të kërkesave më të moderuara, pasi është rritur me 15% numri i atyre që mendojnë se korrupsioni në polici mund të luftohet ‘deri në një farë mase’ (Grafiku 26).

Masat për të cilat një numër më i lartë i qytetarëve pohojnë se janë ‘shumë të efektshme’ për të adresuar korrupsionin janë përmirësimi i shkollimit dhe trajnimit (55%), përmirësimi i pagave (52%), dhënia e dënimeve më të ashpra (51%), dhe përmirësimi i kushteve të punës (48%).



**Grafiku 26.** Besimi se policia është e aftë të luftojë korrupsionin brenda vetes

## 9. INTEGRITETI POLICOR DHE KORRUPSIONI


### 9.1 SONDAZHI ME POLICINË

Përveç sondazhit me publikun, për të ndihmuar në një analizë më të thelluar dhe më të gjerë të problematikës nën studim, u zhvillua dhe një sondazh me punonjës të Policisë. Në përgjithësi punonjësit e policisë shfaqin një mbyllje të theksuar që reflektohet në përgjigjet e dhëna. Kështu, pyetjes sa shpesh dëgjoni për korrupsionin në Polici 66% e qytetarëve i përgjigjen se dëgjojnë ‘thujse gjithmonë’ ose ‘shpesh’, në të njëjtën mënyrë i përgjigjen vetëm 22% dhe 52% e tyre përgjigjen se dëgjojnë ‘rrallë’ për këtë fenomen. (Shihni Shtojcën 2 për të dhënat e plota të sondazhit me punonjësit e policisë.)

Parë nga këndvështrimi i kultivimit të kulturës së integritetit, këto të dhëna tregojnë se me gjithë veprimtarinë dhe debatin e theksuar anti-korrupsion punonjësit e policisë kanë më shumë prirje t’i shmangen sesa të ballafaqohen me problemin e korrupsionit në institucionin e tyre.


Megjithatë, 46% e punonjësve të policisë pranojnë se në PSH ka të korruptuar mes tyre dhe 12% e tyre thonë se korrupsioni në PSH është i përhapur në masë të konsiderueshme.

Kjo prirje vihet re edhe tek përgjigjet e marra kur punonjësit e policisë pyeten për përhapjen e korrupsionit sipas llojeve (Grafiku 27).



**Grafiku 27.** Përhapja e korrupsionit sipas formave dhe llojeve sipas punonjësve të policisë dhe publikut, 2016.

Pavarësisht prirjes për të shmangur ballafaqimin me korrupsionin, kur pyeten për përhapjen e korrupsionit sipas niveleve të menaxhimit, edhe të dhënat nga sondazhi me punonjësit e policisë tregojnë për një përhapje më të lartë të kësaj dukurie në nivelet më të larta të menaxhimit (Grafiku 28).



**Grafiku 28.** Përhapja e korrupsionit sipas niveleve të menaxhimit policor sipas publikut dhe punonjësve të policisë

Tendenca e ndarjes sipas gradave vërehet edhe në përgjigjet për pyetjet ndaj korrupsionit brenda Policisë. Kështu, 14% e të pyeturve thonë se janë ‘dakord’ dhe ‘plotësisht dakord’ se emërimet dhe gradimet në nivelet e larta janë korruptive, ndërsa për gradat e ulta dhe të mesme të njëjtën gjë e pohojnë vetëm 10%. Po ashtu, janë më të shumtë (14%) punonjësit e policisë që thonë se janë ‘dakord’ dhe ‘plotësisht dakord’ se drejtuesit policë e përdorin Policinë për qëllime korruptive, ndërkohë që vetëm 7% pohojnë se punonjësit e policisë e krijojnë vetë mundësinë për korrupsion.


Përsa i përket shkaqeve të korrupsionit, vlen të theksohet numri i lartë i punonjësve të policisë, të cilët pohojnë se korrupsioni në Prokurori (39%) dhe Gjyqësor (41%) është ‘i përhapur’ dhe ‘shumë i përhapur’. Po kështu 29% e punonjësve të policisë pohojnë se ndikimi i tepruar i politikës në Polici përbën një ndër shkaqet e korrupsionit në këtë institucion.

Ndër shkaqet e brendshme, pagat e ulta (52%), trajnimi i dobët (28%), dhe kultura e punës (28%) shihen si faktorët më me ndikim. Nga ana tjetër, vetëm 31% pohojnë se kushtet e punës janë të mira ose shumë të mira. Shumica thonë se janë të pranueshme (43%) dhe 25% thonë se janë të këqija. Përgjigjet për kushtet e punës janë pothuajse të pandryshuara për të dy vitet e matura dhe ka një përputhshmëri të lartë në të dy vitet ndërmjet përgjigjeve të publikut dhe përgjigjeve të punonjësve të policisë (Grafiku 29), çka do të thotë se investimet e kryera për përmirësimin e

infrastrukturën policore nuk kanë pasur ndonjë ndikim dhe se mbetet ende shumë për të bërë në këtë drejtim.


Një problem që del nga përgjigje e dhëna është shkalla e ulët e angazhimit të punonjësve të policisë kundër korrupsionit brenda organizatës. Me gjithë pohimet e mësipërme, 95% e tyre thonë se nuk kanë denoncuar ndonjë punonjës policie dhe po 95% thonë se nuk kanë denoncuar eprorin për korrupsion. Vetëm 4% pohojnë se e kanë bërë këtë akt të paktën një herë.

Ka një sërë faktorësh që ndikojnë në këtë drejtim dhe, siç do të diskutohet në kapitullin në vijim, kultura e solidaritetit dhe e heshtjes ndaj shkeljeve të kolegëve që vazhdon të jetë e theksuar dhe e patrajtuar në PSH, përbën një faktor kryesor. Gjithsesi, siç shihet në grafikun e mëposhtëm, ka një prirje të dukshme të rënies së besimit tek institucionet nga ana e punonjësve të policisë, e shoqëruar nga një rritje po e dukshme të shkallës së mosbesimit (Grafiku 30).



**Grafiku 29.** Vlerësimi i kushteve të punës në Polici nga punonjësit e policisë dhe qytetarët.


Po kështu, të dhënat tregojnë për një shkallë të ulët të njohjes së kuadrit ligjor dhe politikave anti-korrupsion nga ana e punonjësve të policisë. Njohja e rregullave është një nga katër shtyllat që formojnë kuadrin e integritet në një organizatë policore dhe, megjithëse ky ka qenë një problem i identifikuar që në vitin 2014,



**Grafiku 30.** Besimi i punonjësve të policisë se institucionet do ta luftojnë korrupsionin në polici.

Po kështu, të dhënat tregojnë për një shkallë të ulët të njohjes së kuadrit ligjor dhe politikave anti-korrupsion nga ana e punonjësve të policisë. Njohja e rregullave është një nga katër shtyllat që formojnë kuadrin e integritet në një organizatë policore dhe, megjithëse ky ka qenë një problem i identifikuar që në vitin 2014, të dhënat e sondazhit me punonjës të policisë tregojnë se problemi vazhdon të mbetet i patrajtuar (Grafiku 31). Gjithsesi, pavarësisht njohjes së pamjaftueshme të kuadrit ligjor anti-korrupsion, 44% e punonjësve të policisë mendojnë se ky kuadër zbatohet ‘pak’ ose ‘aspak’.

Punonjësve të policisë mendojnë se masat anti-korrupsion janë ‘shumë të efektshme’: përmirësimi i pagave (74%), përmirësimi i kushteve të punës (65%), përmirësimi i trajnimit dhe shkollimit (60%) dhe kontrolli më i mirë i konfliktit të interesit (41%). Nga ana tjetër, mbështetja është më e vogël për masat ndëshkuese. Kështu, vetëm 36% mendojnë se dënimet më të ashpra janë ‘shumë të efektshme’, dhe vetëm 20% mendojnë kështu për zëvendësimin e drejtuesve të policisë si masë anti-korrupsion.



**Grafiku 31.** Njohja e kuadrit ligjor dhe politikave antikorruption nga punonjësit e policisë

## 9.2 INTERVISTAT ME SKENARË

Përtëshqyrtuar dhe ndjekur më tej çështjen e korrupsionit dhe perceptimeve mbi të, ndër forcat e policisë së shtetit, u aplikua edhe instrumenti i pyetësorit me skenarë të veprave të mundshme të korrupsionit në detyrë. Synimi kryesor është që të mund të shihen jo vetëm prirjet individuale të qëndrimeve mbi këto skenarë, por edhe të evidentohet ndonjë hendek i mundshëm midis perceptimeve dhe qëndrimeve individuale dhe qëndrimeve të perceptuara si dominuese mes kolegë. Ky ballafaqim do të rriste masën e objektivitetit të matjes si dhe vlefshmërinë e saj. Nga ana tjetër, mbajtja dhe aplikimi i të njëjtit instrument si edhe në studimin e vitit 2014, mundëson edhe krahasimin në kohë të rezultateve, ndonëse kampionet e mara nuk lejojnë përgjithësimet e gjetjeve për të gjithë popullatën.

Në vijim, analiza e të dhënave të grumbulluara paraqitet e organizuar sipas 4 çështjeve kryesore:

Së pari, krahasohen vlerësimet e përgjigjedhënësve për sa i takon qëndrimeve personale dhe atyre të perceptuara ndër kolegë mbi seriozitetin e sjelljes (shkeljes) së paraqitur në secilin skenar.

Së dyti, krahasohen dhe analizohen masat disiplinore që përgjigjedhënësit mendojnë se duhet të ndërmerren kundrejt atyre që ata presin praktikisht



të ndodhin kundrejt vlerësimit të seriozitetit të veprës së analizua në seksionin pararendës.

Së treti, analizohen tendencat e gatishmërisë personale dhe asaj të perceptuar tek të tjerët për raportimin e shkeljeve të dëshmuara.

Së fundi, raportohet mbi vlerësimin e njohurive të përgjigjedhënësve mbi përputhshmërinë e sjelljeve të paraqitura në skenarë me politikat dhe rregulloret zyrtare.

### **9.3 VLERËSIMI PËR SHKALLËN E SERIOZITETIT TË SJELLJES**

Punonjësit e pyetur rezultojnë të kenë vlerësime prioritizuese për sa i takon seriozitetit të sjelljes që secili prej të 11-të skenarëve parashtrohet. Megjithatë, renditja që rezulton nga qëndrimet dhe besimet personale ka ndryshime me ato të raportuara për kolegët, apo në raport me parashikimin e masave disiplinore që duhet apo që priten të merren (të cilat do të analizohen më tej në seksionin vijues).

Kryerja e një pune të dytë (apo për lehtësi referimi – skenari 1), vazhdon të mbetet, edhe në këtë raund të matjeve, sjellja e vlerësuar si më pak problematike si në planin personal ashtu edhe në atë kolektiv. Në një shkallë vlerësimi nga 1 (aspak e rëndë) në 5 (shumë e rëndë), skenari 1 ka në total mesataren më të ulët të vlerësimeve me 1.88. Ndërkohë, përgjigjja më e shpeshtë ka qenë 1, pra një sjellje që në shumicën e herëve ka marrë vlerësimin ‘aspak e rëndë’. Ky është edhe vlerësimi i raportuar më shpesh për sa i takon frymës që perceptohet në përgjithësi tek punonjësit e policisë.

Nëse krahasojmë përgjigjet e përftuara nga pyetjet mbi qëndrimet personale kundrejt atyre që vërehen ndër kolegë, mund të shohin se skenari 1 është i vetmi skenar ku balanca e seriozitetit të sjelljes anon nga ajo e qëndrimeve të kolegëve. Kështu pra, për sjelljen që në totalin e vlerësimeve personale gjykohet si ‘aspak e rëndë’, kolegët priten që t’i japin më shumë rëndësi sesa vetë përgjigjedhënësi. Raporti shkon në të kundërt në të gjitha sjelljet e tjera (Shiko Figurën 1 për një paraqitje vizuale).

Vlerësimi individual për seriozitetin e sjelljes vijon të ketë një renditje të ngjashme ashtu si edhe në studimin e parë (2014). I vetmi ndryshim që vihet re është një shkëmbim i vendeve të skenarit 6 (marrjes së përqindjes për rekomandim) dhe skenarit 7 (keqpërdorimit të kompetencave të parashikuara).

SERIOZITETI I SHKELJES				
SKENARI	Qëndrimi im Sa të rëndë e mendoni JU këtë sjellje?		Qëndrimi i kolegëve sipas meje Sa të rëndë e mendojnë SHUMICA E PUNONJËSVE TË POLICISË TË RAJONIT/DREJTORISË TUAJ këtë sjellje?	
	Mesatarja	Moda	Mesatarja	Moda
<b>Skenari 1</b> Kryerja e një pune të dytë	1.88	Aspak e rëndë	2.16	Aspak e rëndë
<b>Skenari 4</b> Pranim shpërblimi nga qytetarë jashtë shërbimit	2.87	Aspak e rëndë	2.86	Aspak e rëndë
<b>Skenari 8</b> Mbulim i shkeljes së një kolegu	3.44	Shumë e rëndë	3.37	Shumë e rëndë
<b>Skenari 2</b> Pranim shpërblimi nga qytetarë gjatë shërbimit	3.45	Shumë e rëndë	3.34	Shumë e rëndë
<b>Skenari 6</b> Marrje përqindje për rekomandim	3.78	Shumë e rëndë	3.55	Shumë e rëndë
<b>Skenari 7</b> Keqpërdorim i kompetencave të parashikuara	3.97	Shumë e rëndë	3.82	Shumë e rëndë
<b>Skenari 10</b> Përdorim të tepruar force	4.13	Shumë e rëndë	3.95	Shumë e rëndë
<b>Skenari 9</b> Pranim dhurate për të shpërfillur shkelje të ligjit	4.37	Shumë e rëndë	4.12	Shumë e rëndë
<b>Skenari 11</b> Vjedhje e sendeve të gjetura	4.63	Shumë e rëndë	4.52	Shumë e rëndë
<b>Skenari 3</b> Marrje ryshfeti	4.81	Shumë e rëndë	4.46	Shumë e rëndë
<b>Skenari 5</b> Vjedhje nga vendi i krimit	4.87	Shumë e rëndë	4.73	Shumë e rëndë


**Tabela 7.** Skenarët e renditur sipas vlerësimit individual kundrejt vlerësimit të raportuar për kolegët.

Skenarët që marrin vlerësimin mesatar më të lartë për sa i takon problematikës që parashtrojnë mbeten skenari 3 (marrja e ryshfetit) dhe skenari 5 (vjedhja nga vendi i krimit). Renditja e plotë e skenarëve sipas seriozitetit të raportuar të sjelljes paraqitet në Tabelën 2.

Pavarësisht larmisë së skenarëve dhe variacionit në vlerësime, asnjë prej tyre nuk konsiderohet ‘shumë i rëndë’ prej të gjithë përgjigjedhënësve. Për më tepër, me përjashtim të rastit të skenarit 1, komentuar më herët, në të gjitha rastet e tjera, vlerësimi për seriozitetin e sjelljes bie nga qëndrimi personal tek qëndrimi i perceptuar tek kolegët. Hendeku më i madh gjendet në një prej dy skenarëve të vlerësuar si nga më të rëndët, në skenarin 3.

Është pikërisht marrja e ryshfetit, vepër me të cilën më së shumti identifikohet korrupsioni, e cila raportohet të vlerësohet më e rëndë personalisht nga të pyeturit sesa nga koleget e tyre (Grafiku 32).

### QËNDRIMET PERSONALE KUNDREJT ATYRE TË PERCEPTUARA NDËR KOLEGË



**Grafiku 32.** Vlerësimi i seriozitetit të sjelljeve (në vlerë mesatare, 1=aspak e rëndë deri në 5=shumë e rëndë)

Identifikimi i ryshfetit si sjellja më e rëndë korruptive tregon edhe

pamjaftueshmërinë e informimit dhe trajnimit të punonjësve të policisë mbi korrupsionin dhe format e tij në PSH. Në të njëjtën mënyrë mund të interpretohet edhe qëndrimi ndaj vjedhjes, skenari 5, e cila për shkak se konsiderohet shoqërisht e dënueshme është vlerësuar si shkelja më e rëndë.

Interesante është të nënvijëzohet edhe polarizimi i vlerësimit për seriozitetin e shkeljeve, nëse krahasojmë ato të raportuara për skenarin 3 dhe skenarin 4. Ndërsa marrja e ryshfetit vlerësohet si një nga shkeljet më të rënda (me një mesatare 4.81 dhe modë 5), skenari 4 (pranimi i shpërblimit nga qytetarët jashtë shërbimit) pozicionohet në polin tjetër, si një nga sjelljet më pak problematike (me mesatare rreth 2.9 dhe modë 1 ‘aspak e rëndë’). Megjithatë, për një interpretim më të thelluar të këtyre referencave do të duhet të ndërmerren analiza të mëtejshme.

#### **9.4 MASAT DISIPLINORE DHE APLIKIMI I TYRE**

Në përgjithësi, renditja e skenarëve sipas masave disiplinore që përgjigjedhësit raportojnë se duhet të merren në rastet e sjelljeve të synuara përputhet me atë të vlerësimit të seriozitetit të tyre (me përjashtim të skenarëve 2 dhe 8 që shkëmbejnë vendet, por pa ndonjë lëvizje madhore në renditjen e përgjithshme). Më pas, duke krahasuar vlerësimet për masat disiplinore që mendohet se duhen kundrejt atyre që raportohen se do kishin më shumë të ngjarë të ndodhnin në realitet, shfaqet një tendencë kontradiktore ku, për skenarët me shkallë serioziteti të lartë masat disiplinore që priten raportohen më të rënda sesa ato që mendohen se duhet të merren.

E kundërta ndodh me skenarët që për nga serioziteti i shkeljes renditeshin si më të rëndët, skenarin 3 (marrje ryshfeti) dhe 5 (vjedhje nga vendi i krimit). Për këto dy skenarë si dhe për skenarin 7 (keqpërdorimi i kompetencave) masat disiplinore që pritet të merren nëse këto shkelje ndodhin janë më të buta sesa ato që përgjigjedhënesit besojnë se duhet të merren (Tabela 3 jep më tepër informacion). Në përgjithësi, qëndrimet e raportuara tregojnë për një ashpërsim të masave disiplinore për veprat ‘më të lehta’ dhe një mungesë ndëshkueshmërie sipas pritshmërive për shkeljet e konsideruara ‘më të rënda’.

Nëse gjetjet e këtij vrojtimi krahasohen me ato të vrojtimit të mëparshëm (2014), mund të vihet re një rritje e shkallës së ‘ndërgjegjësimit’ për masat disiplinore. Ndërsa më herët për një pjesë të mirë të shkeljeve përgjigjedhënesit propozonin masa më të lehta disiplinore, ku mbizotëronin vërejtjet me gojë (IDM, 2014 f. 95), në këtë vrojtim ka ndryshim në përgjigjet e marra.

DISIPLINA	Masa disiplinore që DUHET (p. 4)		Masa disiplinore që PRITET (p. 5)	
	Mesatarja	Moda	Mesatarja	Moda
	<b>Skenari 1</b> Kryerja e një pune të dytë	1.98	Asnjë	1.99
<b>Skenari 4</b> Pranim shpërblimi nga qytetarë jashtë shërbimit	2.48	Asnjë	2.57	Asnjë
<b>Skenari 2</b> Pranim shpërblimi nga qytetarë gjatë shërbimit	2.87	Vërejtje me shkrim	3.00	Vërejtje me shkrim
<b>Skenari 8</b> Mbulim i shkeljes së një kolegu	3.14	Vërejtje me shkrim	3.17	Vërejtje me shkrim
<b>Skenari 10</b> Përdorim të tepruar force	3.28	Vërejtje me shkrim	3.41	Vërejtje me shkrim
<b>Skenari 7</b> Keqpërdorim i kompetencave të parashikuara	3.34	Vërejtje me shkrim	3.27	Vërejtje me shkrim
<b>Skenari 9</b> Pranim dhurate për të shpërfillur shkelje të ligjit	3.36	Vërejtje me shkrim	3.44	Vërejtje me shkrim
<b>Skenari 6</b> Marrje përqindje për rekomandim	3.49	Vërejtje me shkrim	3.51	Vërejtje me shkrim
<b>Skenari 11</b> Vjedhje e sendeve të gjetura	4.18	Shkarkim nga puna	4.21	Shkarkim nga puna
<b>Skenari 3</b> Marrje rryshfeti	4.60	Shkarkim nga puna	4.57	Shkarkim nga puna
<b>Skenari 5</b> Vjedhje nga vendi i krimit	5.22	Shkarkim nga puna	5.18	Shkarkim nga puna



**Tabela 8.** Renditja e skenarëve sipas mesatares së masës disiplinore që duhet marrë kundrejt atyre që pritet të merren.

Siç ilustron në mënyrë të përmbledhur në grafikët më poshtë, përveç skenarëve 1 dhe 4, të vlerësuar më herët edhe si më pak të rëndë, tek të cilët dominon si masë disiplinore alternativa ‘asnjë’, në të gjithë skenarët e tjerë mbizotërojnë alternativat e ‘vërejtjes me shkrim’ dhe ‘shkarkimi nga puna’.





Pavarësisht tendencës për të mbështetur masa disiplinore më të rënda se në vitin 2014, pasaktësitë dhe mospërputhjet në raport me parashikimet zyrtare vazhdojnë ende. Për shembull, masa disiplinore më e raportuar për shkeljen e ‘përdorimit të paarsyeshëm të forcës’ nga ‘vërejtje me gojë’ tani ka kaluar në ‘vërejtje me shkrim’, nuk përputhet ende me parashikimin e rregullores si shkelje të dënueshme me ‘përgjashtim nga policia’, pra largim nga puna.<sup>85</sup> Megjithatë, është me interes të kuptohet ky ndryshim me kah drejt mbështetjes së ashpërsimit të masave disiplinore.

Do të duhej të mblidheshin të dhëna të tjera për të analizuar dhe kuptuar nëse ky është një rezultat i ndikuar nga një rritje e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese, nga ashpërsimi i masave të ndërmarra realisht kur vepra të tilla hasen mes forcave të PSH, apo një kombinim i të dy faktorëve.

Masat disiplinore që duhen marrë, shpërndarja sipas skenarëve:



85 Shiko Rregulloren e Disiplinës Neni 11, pika 14 dhe Neni 10, pika 2




### SKENARI 7



### SKENARI 8



### SKENARI 9




### SKENARI 10





SKENARI 11



**Grafiku 33.** Masat disiplinore që duhen marrë: shpërndarja sipas skenarëve

## 9.5 RAPORTIMI I SHKELJEVE: PERCEPTIME MBI

### GATISHMËRINË INDIVIDUALE DHE ATË KOLEKTIVE


Duke iu referuar gjetjeve mbi gatishmërinë për raportimin e këtyre shkeljeve rezulton se nuk ka ndonjë rritje të dukshme të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi shkeljet dhe masat disiplinuese përkatëse. Gjetjet në këtë drejtim konfirmojnë se kultura e heshtjes, e cila bie ndesh me kulturën integritetin policor, vazhdon të qëndrojë e pacenuar. Gatishmëria për raportimin e shkeljeve vazhdon të mbetet e ulët. Madje, mos-gatishmëria shpërfaqet me nuancat e një vlere. Vetëm në rastin e gatishmërisë për raportim, vlerat mesatare për qëndrimet individuale janë më të ulëta se ato mbi perceptimet për gatishmërinë e kolegëve, siç jepen në tabelën dhe figurën më poshtë.

Përrjashtim nga ky trend i përgjithshëm përbëjnë vetëm skenarët që vlerësohen nga përgjigjedhënsit edhe si më seriozët. Skenarët 3, 5 dhe 7 konsiderohen si ata që mesatarisht do të gjenin më shumë gatishmëri individuale për raportim sesa ndër kolegë. Duket se ndjeshmëria më e lartë vazhdon të lidhet me një tipologji të caktuar shkeljesh që përfshijnë marrjen e ryshfetit, vjedhjet nga vendi i krimit dhe keqpërdorimin e kompetencave. Situata rezulton e përmbysur për shkelje që konsiderohen ‘aspak’ apo ‘pak serioze’ si ato të paraqitura në skenarët 1 dhe 2 (kryerja e një pune të dytë dhe pranimi i shpërblimeve jashtë shërbimit).

GATISHMËRIA PËR RAPORTIM	Nga VETE unë (p. 6)		Nga SHUMICA e kolegëve (p. 7)	
	Mesatarja	Moda	Mesatarja	Moda
	<b>Skenari 1</b> Kryerja e një pune të dytë	2.40	Absolutisht jo	2.69
<b>Skenari 4</b> Pranim shpërblimi nga qytetarë jashtë shërbimit	2.80	Absolutisht jo	2.94	Sigurisht që po
<b>Skenari 2</b> Pranim shpërblimi nga qytetarë gjatë shërbimit	3.17	Sigurisht që po	3.40	Sigurisht që po
<b>Skenari 8</b> Mbulim i shkeljes së një kolegu	3.17	Sigurisht që po	3.29	Sigurisht që po
<b>Skenari 6</b> Marrje përqindje për rekomandim	3.53	Sigurisht që po	3.54	Sigurisht që po
<b>Skenari 7</b> Keqpërdorim i kompetencave të parashikuara	3.57	Sigurisht që po	3.51	Sigurisht që po
<b>Skenari 10</b> Përdorim të tepruar force	3.61	Sigurisht që po	3.68	Sigurisht që po
<b>Skenari 9</b> Pranim dhurate për të shpërfillur shkelje të ligjit	3.71	Sigurisht që po	3.77	Sigurisht që po
<b>Skenari 11</b> Vjedhje e sendeve të gjetura	4.00	Sigurisht që po	4.02	Sigurisht që po
<b>Skenari 3</b> Marrje ryshfeti	4.06	Sigurisht që po	4.00	Sigurisht që po
<b>Skenari 5</b> Vjedhje nga vendi i krimit	4.45	Sigurisht që po	4.32	Sigurisht që po

**Tabela 9.** Gatishmëria për raportimin e shkeljeve.

### GATISHMËRIA PËR RAPORTIM (VLERA MESATARE)



**Grafiku 33.** Diferenca në gatishmërinë për raportim të shkeljeve

## 9.6 NJOHURITË OBJEKTIVE MBI SHKELJET DHE PËRPUTHSHMËRINË ME POLITIKAT ZYRTARE

Përveç pyetjeve që vilnin opinione dhe qëndrime, përgjigjedhësve, punonjës të Policisë së Shtetit, iu drejtuan edhe pyetje për të mësuar sa njohuri kanë për politikën zyrtare por edhe shkallën e mbështetjes për të duke iu kërkuar të vlerësonin në bazë të njohjes së politikave dhe linjës zyrtare të PSH përputhshmërinë/pranueshmërinë e sjelljeve që përshkruhen në secilin skenar. Rezultatet sipas një shkalle nga 1 = ‘absolutisht jo’ deri në 5 = ‘absolutisht po’ paraqiten në Tabelën 10.

Kolona ‘Mesatarja’ tregon për vlerësimin mesatar të secilit skenar, ndërsa moda, vlerën e raportuar më shpesh. Siç mund të vihet re, ndonëse vlera më e përsëritur në thujtje të gjithë skenarët (përveç atij me numër 1) është 5, apo ‘absolutisht po’, pra në mospërputhje të plotë me politikën dhe rregulloret zyrtare, asnjë prej veprave nuk arrin këtë vlerë në unanimitet nga të gjithë përgjigjedhësit. Skenari më i rëndë është renditur edhe si më në mospërputhje me politikën zyrtare, por edhe vlera mesatare e tij shkon në 4.8.

<b>Përputhshmëria me politikën zyrtare</b>		
	<b>Mesatarja</b>	<b>Moda</b>
Skenari 1 <b>Kryerja e një pune të dytë</b>	2.49	Absolutisht jo
Skenari 4 <b>Pranim shpërblimi nga qytetarë jashtë shërbimit</b>	3.14	Sigurisht që po
Skenari 2 <b>Pranim shpërblimi nga qytetarë gjatë shërbimit</b>	3.72	Sigurisht që po
Skenari 8 <b>Mbulim i shkeljes së një kolegu</b>	3.94	Sigurisht që po
Skenari 6 <b>Marrje përqindje për rekomandim</b>	4.02	Sigurisht që po
Skenari 7 <b>Keqpërdorim i kompetencave të parashikuara</b>	4.15	Sigurisht që po
Skenari 10 <b>Përdorim të tepruar force</b>	4.23	Sigurisht që po
Skenari 9 <b>Pranim dhurate për të shpërfillur shkelje të ligjit</b>	4.51	Sigurisht që po
Skenari 11 <b>Vjedhje e sendeve të gjetura</b>	4.67	Sigurisht që po
Skenari 3 <b>Marrje ryshfeti</b>	4.74	Sigurisht që po
Skenari 5 <b>Vjedhje nga vendi i krimit</b>	4.81	Sigurisht që po


**Tabela 10.** A konsiderohet sjellja e përshkruar si një shkelje e linjës zyrtare dhe politikave të policisë?

## 9.7 PËRVOJA NË POLICINË E SHTETIT DHE QËNDRIMET NDAJ SHKELJEVE

Vitet e fundit kanë njohur reformime në raport me edukimin dhe përgatitjen e personelit të PSH ashtu si edhe në raport me strategjitë e trajnimit për sjelljet korruptive apo jo-etike. Për këtë arsye, një eksplorim me interes në këtë raund të matjeve lidhet me vëzhgimin nëse këto ndërhyrje do të kishin prodhuar ndonjë ndryshim që mund të evidentohet në ndonjë mënyrë. Kështu, gjatë zhvillimit të intervistave u synua një nëngrup (30% e të intervistuarve) punonjësish me më pak se 5 vjet përvojë në radhët e PSH me premisën se punonjësit më të rinj kanë qenë edhe më të ekspozuar ndaj programeve të trajnimit të ndryshuara. Për këtë qëllim, në kampionin e marrë në shqyrtim janë përfshirë një peshë e ngjashme e të dy nënkategorive dhe në analizë janë krahasuar mesataret e dy nënkategorive.

Ndryshe nga pritshmëritë për një shkallë tolerance më të ulët tek punonjësit më të rinj të policisë që u intervistuan në këtë studim, në pjesën më të madhe janë grupi i atyre me vjetërsi më të madhe në PSH që ka një mesatare me të lartë vlerësimi, si për rëndësinë e veprës ashtu edhe për elemente të ndëshkimit dhe raportimit të saj. Kështu, këtu do të vëmë në dukje vetëm rastet kur nga analiza e të dhënave ka rezultuar e kundërta. Më poshtë do të tregojmë se grupi me më pak përvojë ndodh që të ketë rezultate më të larta se grupi i referencës vetëm në skenarët që në përgjithësi janë vlerësuar si më problematikët: skenarët 3, 5 ashtu edhe në skenarët 7 dhe 9.

Kështu, marrja e ryshfetit dhe vjedhja nga vendi i krimit vlerësohen si më të rënda nga punonjësit me më pak përvojë (ndonëse diferencat janë shumë të ngushta). Situata është e ngjashme edhe për skenarët 7 dhe 9. Keqpërdorimi i kompetencave si dhe pranimi i dhuratave për të shpërfillur shkelje të ndryshme të ligjit raportohen si vepra më të rënda dhe më në mospërputhje me politikat zyrtare nga grupi me më pak eksperiencë në polici. Po ndërsa diferencat edhe këtu janë shumë të ngushta, ajo që ndoshta meriton një vëmendje më të madhe në këtë analizë ashtu edhe në studime të mëtejshme lidhet me çështjen e gatishmërisë për raportimin e shkeljeve dhe shtrirjen e kodit të heshtjes.



**Grafiku 34.** Gatishmëria për raportimin e shkeljeve (në vlerë mesatare të shkallës nga 1, absolutisht jo – 5, sigurisht që po).

Grafiku më sipër tregon një tendencë të qartë diference në gatishmërinë për raportim të shprehur nga punonjësit me më pak vite eksperiencë kundrejt atyre me vjetërsi pune më të madhe në radhët e policisë. Në asnjë prej skenarëve të paraqitur nuk ka një mesatare më të lartë gatishmërie ndër të pyetur i grupit me më pak se 5 vjet eksperiencë. Në një kontekst më të gjerë analize dhe krahasimi me gjetjet e mësipërme mund të argumentohet se kodi i heshtjes përforcohet me ashpërsimin e qëndrimeve dhe ndëshkimeve ndaj shkeljeve.

## 10. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky studim analizon korrupsionin policor në Shqipëri me qëllim që të vlerësojë tendencat e korrupsionit policor dhe masat anti-korrupsion për periudhën 2014-2016.

Analiza e perceptimeve të publikut dhe e të dhënave të marra nga sondazhe dhe intervista me punonjës të policisë tregojnë se korrupsioni policor në Shqipëri vazhdon të mbetet i përhapur dhe se arritjet deri tani janë të pjesshme dhe vetëm në disa aspekte të policimit apo segmente të

## PSH.

Analiza kuadrit dhe masave antikorrupsion tregon se, me gjithë ambicien e objektivave të vendosur në kuadrin strategjik dhe rishikimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, faktorët kryesorë që ndikojnë në korrupsionin policor lidhen me pamjaftueshmërinë e burimeve, politizimin e luftës kundër korrupsionin, motivimin e pamjaftueshëm të punonjësve të policisë, besimin e tyre të ulët tek institucioni dhe keqshpërndarje të përgjegjësive dhe kompetencave.

Ky studim është një kontribut i mëtejshëm në përpjekjet e shoqërisë në përmirësimin dhe forcimin e kuadrit antikorrupsion por edhe në plotësimin e studimeve empirike mbi korrupsionin policor në Shqipëri.

Lufta ndaj korrupsionit policor është një proces i gjatë dhe e vazhdueshëm dhe ka nevojë të konceptohet në radhë të parë si përgjegjësi e vetë Policisë së Shtetit. Edhe pse vullneti politik është i domosdoshëm për të siguruar kushtet e përshtatshme që Policia të realizojnë me sukses dhe efektivitet proceset antikorrupsion, ai nuk është i mjaftueshëm.

Organizatrat policore kanë tiparet dhe kulturën e tyre specifike organizative që përbën dhe faktorin kryesor se përse ky lloj korrupsioni ekziston, kulturë dhe tipare të cilat i mbijetojnë ciklevë qeverisëse.

Politizimi i luftës kundër korrupsionit në polici ka ardhur dhe me koston e rritjes së perceptimit tek qytetarët dhe punonjësit e policisë se institucionet politike e përdorin Policinë për qëllime korruptive. Përveçse ka shpënë në uljen e besimit në këto institucione, politizimi krijon premisat që në ciklin e ardhshëm politik, kurdo që të ndodhë, Policia të përballet me një presion reformues të natyrës politike, i cili do të riciklojë problemin por nuk do të kontribuojë në zgjidhjen e tij. Për këtë arsye, nevojitet një ndarje më e qartë e kompetencave, përgjegjësive dhe rolit në komunikimin publik ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit.

Perceptimi i qytetarëve dhe reflektimi i këtyre perceptimeve në politikat dhe masat antikorrupsion kontribuojnë në forcimin e integritetit të organizatës së Policisë së Shtetit dhe rritjen e besimit ndaj saj.

Një rol më të madh nevojitet të marrë Parlamenti si në drejtim të monitorimit të proceseve anti-korrupsion ashtu edhe në drejtim të llogaridhënies për mungesën e përparimit dhe për mosrealizimin e objektivave të vendosur.

Vetë PSH duhet të bëjë më tepër në drejtim të përdorimit më me efektivitet dhe efikasitet të burimeve dhe mjeteve që ka në dispozicion kryesisht në drejtim të parandalimit të korrupsionit.

Përmirësimi i kapaciteteve trajnuese në Akademinë e Policisë duhet të

shoqërohet me vënien në efikasitet të këtyre kapaciteteve për të rritur rolin e edukimit dhe trajnimit si instrumente të forcimit të integritetit.

Njohja e dobët e punonjësve të policisë me rregullat antikorruption, shkalla e ulët e mbështetjes që ata kanë dhe kultura e fortë e heshtjes ndaj keqsjelljes duhet të jenë në fokus të programeve të edukimit dhe trajnimit të punonjësve të policisë. Në këtë aspekt, një vend i veçantë duhet t'i jepet trajnimeve të etikës dhe përfshirjes së etikës si pjesë integrale e kulturës policore.

Edhe pse përfitimi monetar, material dhe i favoreve zë vendin kryesor kur analizohen shtysat e korrupsionit, përdorimi i tepruar i forcës vazhdon të mbetet një nga tiparet më negative dhe pothuajse të patrajtuara të PSH.



Verifikimi psikologjik dhe i personalitetit të punonjësve, mënjanimi i atyre që janë të cenueshëm nga pozicione në të cilat nevojitet përdorimi i forcës për kryerjen e detyrës dhe dhënia e trajnimeve të nevojshme janë masa me kosto të papërfillshme dhe të realizueshme lehtësisht nga PSH, por që kanë ndikim të madh në perceptimin e publikut.












# SHTOJCA 1 - RAPORT I DETAJUAR I GJETJEVE TË ANKETIMIT ME PUBLIKUN

## 1.1 TË DHËNA DEMOGRAFIKE






<b>1. Gjinia:</b>				%
Mashkull	<input type="checkbox"/> 1	<b>545</b>		50
Femër	<input type="checkbox"/> 2	<b>536</b>		50

<b>3. Banoni në zonë urbane (qytet) apo rurale (fshat)?</b>				
Zonë urbane	<input type="checkbox"/> 1	<b>635</b>		59
Zonë rurale	<input type="checkbox"/> 2	<b>439</b>		41






<b>4. Cilës grupmoshe i përkisni?</b>				
18 – 25 vjeç	<input type="checkbox"/> 1	<b>251</b>		23
26- 35 vjeç	<input type="checkbox"/> 2	<b>245</b>		23
36 – 45 vjeç	<input type="checkbox"/> 3	<b>218</b>		20
46 – 55 vjeç	<input type="checkbox"/> 4	<b>207</b>		19
Mbi 55 vjeç	<input type="checkbox"/> 5	<b>160</b>		15

<b>5. Cili është niveli më i lartë i arsimit që keni kryer?</b>				
Arsim 8-vjeçar	<input type="checkbox"/> 1	<b>566</b>		53
Arsim i mesëm	<input type="checkbox"/> 2	<b>324</b>		30
Arsim universitar	<input type="checkbox"/> 3	<b>59</b>		5
Arsim pas-universitar	<input type="checkbox"/> 4	<b>125</b>		12






## 1.2. INFORMIMI MBI KORRUPSIONIN

<b>6. Cilat janë mjetet tuaja kryesore të informimit për zhvillimet e përgjithshme në vend? Mundet më shumë se një alternative.</b>				
TV	<input type="checkbox"/> 1	<b>590</b>		55
Gazetat	<input type="checkbox"/> 2	<b>164</b>		15
Interneti	<input type="checkbox"/> 3	<b>174</b>		16
Radio	<input type="checkbox"/> 4	<b>21</b>		2
Miqtë / shokët / familja	<input type="checkbox"/> 5	<b>130</b>		12






**7. A keni dëgjuar të flitet për korrupsionin në Polici?**

Thujse gjithmonë	<input type="checkbox"/> 1	<b>257</b>		24
Shpesh	<input type="checkbox"/> 2	<b>526</b>		49
Rrallë	<input type="checkbox"/> 3	<b>264</b>		25
Asnjëherë	<input type="checkbox"/> 4	<b>21</b>		2
Refuzim (shko tek pyetja 9)	<input type="checkbox"/> 99	<b>4</b>		0

**8. Nga cili burim dëgjoni më shumë për korrupsionin në polici?**

Media	<input type="checkbox"/> 1	<b>737</b>		70
Eksperiencia personale	<input type="checkbox"/> 2	<b>84</b>		8
Rrethi shoqëror / familjar	<input type="checkbox"/> 3	<b>232</b>		22
Tjetër. Specifikoni _____	<input type="checkbox"/> 4	<b>3</b>		0
Refuzim	<input type="checkbox"/> 99	<b>1</b>		0

**9. Sa shpesh dëgjoni ose ndesheni me informacion për oficerë policie të korruptuar?**






Thujse gjithmonë	<input type="checkbox"/> 1	<b>194</b>		18
Shpesh	<input type="checkbox"/> 2	<b>511</b>		48
Rrallë	<input type="checkbox"/> 3	<b>335</b>		31
Asnjëherë	<input type="checkbox"/> 4	<b>26</b>		2
Nuk e di / refuzim	<input type="checkbox"/> 99	<b>1</b>		0

### 1.3 PERCEPTIMET MBI KORRUPSIONIT

